



---

## Zyra administrative

---

### ÇFARË

Është pjesë e Administratës Financiare të Republikës së Sllovenisë në Ministrinë e Financave. Ju mund ti kontaktoni ata në lidhje me taksat, kthimin e taksave dhe statusin e rezidentit për qëllime tatimore.

---

### MIRË ËSHTË TA DINI

Burimet në internet lidhur me taksat janë në dispozicion në faqen e internetit (në anglisht):

<https://www.investslovenia.org/business-environment/taxes-accounting/>

[http://europa.eu/youreurope/citizens/work/taxes/income-taxes-abroad/slovenia/index\\_en.htm](http://europa.eu/youreurope/citizens/work/taxes/income-taxes-abroad/slovenia/index_en.htm)

[http://www.fu.gov.si/en/taxes\\_and\\_other\\_duties/areas\\_of\\_work/international\\_taxation/](http://www.fu.gov.si/en/taxes_and_other_duties/areas_of_work/international_taxation/)

---

### KU

Zyra përgjegjëse për vendin tuaj të banimit, mund ta gjeni në: <http://www.fu.gov.si>



---

## Lista e burimeve të internetit për kompaninë

---

### PORTAL SLOVENIA BUSINESS POINT (PIKA E VETME E KONTAKTIT)

#### ÇFARË

Ky është një portal në gjuhën angleze që siguron të gjithë informacionin e nevojshëm për themelimin e një kompanie në Slloveni.

#### KU

(në anglisht) <http://eugo.gov.si/en/about-the-portal/>

---

### SPOT - PIKA SLOVENE E BIZNESIT

#### ÇFARË

Gjithashtu mund të merrni më shumë informacion rreth themelimit të një kompanie në Slloveni. Në këtë portal mund të regjistroni disa lloje të bizneseve në mënyrë elektronike.

#### KU

(në anglisht): <http://eSPOT.gov.si/info/sistem-spot/>

---

### PORTAL INVEST SLOVENIA

#### ÇFARË

InvestSlovenia Team operon në kuadër të SPIRIT Slovenija (Agjencia Publike e Republikës së Sllovenisë për Promovimin e Ndërmarrësisë, Ndërkombëtarizimit, Investimeve të Huaja dhe Teknologjisë), me detyra rregullatore, profesionale dhe zhvillimore për të rritur konkurrueshmërinë e ekonomisë sllovene në fushën e sipërmarrjes, ndërkombëtarizimit, investimeve të huaja dhe teknologji. Ekipi i InvestSlovenia vepron si një “dyqan me një ndalesë” për investitorët potencialë dhe drejton bazat e të dhënave me projektet e investimeve publike dhe private



---

dhe tokën për qëllime komerciale dhe industriale në të gjithë sektorët ekonomikë. Informacioni është i disponueshëm pa pagesë për të plotësuar nevojat specifike dhe buxhetet e investitorëve.

#### KU

(në anglisht dhe frëngjisht): <https://www.investslovenia.org/>

---

### **FAQJA E INTERNETIT DATA, D. O. O.**

#### ÇFARË

DATA, d. o. o. është një kompani private. Ofrojnë asistencë për shtetasit e huaj (të gjitha në një vend: marrja e numrave tatimorë sllovenë, përkthimi i dokumenteve të nevojshme, regjistrimi i lirë i kompanive për marrjen e lejeve të punës për të huajt, ndihma në transferimin e vendeve të punës tek punëtorët etj.).

#### KU

(në anglisht, gjermanisht, kroatisht, boshnjakisht, serbisht, rusisht, italisht, kinezisht, arabisht): <https://data.si/en/>



---

## Lista e shërbimeve për ndihmë dhe projekte në mbështetje të biznesit

---

### AGJENCIA E REPUBLIKËS SË SLOVENISË PËR REGJISTRIMET LIGJORE PUBLIKE DHE SHËRBIME - AJPES

#### ÇFARË

Ajpesi e menaxhon Regjistrin e Bizneseve të Sllovenisë si një bazë të dhënash publike qendrore të të gjitha subjekteve afariste, filialeve të tyre dhe pjesëve të tjera të subjekteve afariste në Slloveni që kryejnë një veprimtari fitimprurëse ose jofitimprurëse.

#### KU

Më shumë informacione keni në dispozicion në faqen e internetit (në anglisht):

<https://www.ajpes.si/?language=english>

---

### SPOT PIKA SLOVENE TË BIZNESIT

#### ÇFARË

Në kuadrin e shërbimeve mbështetëse të shtetit për subjektet afariste, është prezantuar një sistem i ri kombëtar SPOT, pikat slovene të biznesit. Nën kujdesin e Pikës slovene të biznesit, gradualisht është duke kaluar edhe sistemi ekzistues SPOT, si pika dhe portali për kompanitë dhe sipërmarrësit e-SPOT. Të gjitha shërbimet e ofruara nga pikat SPOT janë pa pagesë. Ngarkohen shërbimet noteriale.

#### KU

Lista e pikave SPOT dhe noterëve publik (në gjuhën sllovene):

<http://eSPOT.gov.si/info/sistem-spot/>

---



---

## INKUBATORËT E BIZNESIT NË SLLOVENI

### ÇFARË

Një inkubator biznesi është një organizatë e dizajnuar për të nxitur rritjen dhe suksesin e kompanive duke ofruar mbështetje të ndryshme. Në inkubatorin e ndërmarrjes do të gjeni të gjitha llojet e ekspertizës në tema të ndryshme që do t'ju udhëheqin përmes procesit të themelimit të kompanisë suaj. Mbështetja e një inkubatori sipërmarrës ndihmon jo vetëm në fillimin e një biznesi, por në të vërtetë mund të rrisë shanset edhe për sukses të mëtejshëm.

### KU

Lista e inkubatorëve sipërmarrës, inkubatorë universiteti dhe parqe teknologjike në Slloveni është në dispozicion në faqen e internetit (në gjuhën sllovene):  
) : <https://www.podjetniski-portal.si/ustanavljam-podjetje/inovativno-okolje/Evidenca-subjektov-inovativnega-okolja>

---

## DHOMA E ARTIZANATIT DHE BIZNESIT TË VOGËL TË SLLOVENISË

### ÇFARË

Është një organizatë ombrellë që përfshin një sistem të dhomave të zanateve dhe bizneseve.

### KU

Dhoma e Artizanatit dhe Bizneseve të Vogla të Sllovenisë (Chamber of Craft and Small Business of Slovenia)

Celovška cesta 71, 1000 Ljubljana

Telefoni: +386 1 583 05 01

<http://www.ozs.si>

Email: [info@ozs.si](mailto:info@ozs.si)

---

## ODA E TREGTISË DHE INDUSTRIË SË SLLOVENISË

### ÇFARË

Ofron shërbime për kompanitë që operojnë në Slloveni dhe u ofron anëtarëve të



---

saj qindra ekspertë dhe specialistë nga shumë sektorë në Slloveni, si tregtia, industria, turizmi dhe shërbimet.

## KU

Oda e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë (Chamber of Commerce and Industry of Slovenia)

Dimičeva 13, 1504 Ljubljana

Telefoni: 386 1 5898 000

<https://www.gzs.si/eng>

Email: [info@gzs.si](mailto:info@gzs.si)



# Lista e shërbimeve për ndihmë dhe projekte që lidhen me punësimin

## ENTI I REPUBLIKËS SË SLOVENISË PËR PUNËSIM

### ÇFARË

Enti i Republikës së Sllovenisë për Punësimë të Institutit i Qeverisë Qendrore që i ndihmon punëkërkuesit të gjejnë punë në të gjithë Slloveninë. Nëse jeni i papunë, regjistrohuni në regjistrin e të papunëve. Ju mund të regjistroheni personalisht vetëm me një dokument të vlefshëm personal. Shërbimi i punësimit ju ofron vende të lira pune dhe një këshilltar profesional personal që t'ju ndihmojë të gjeni një punë dhe të zhvilloni një karrierë të mëtejshme.

### KU

Zyra më e afërt lokale e Entit (ZRSZ) mund ta gjeni në faqen e internetit (në gjuhën sllovene):

[https://www.ess.gov.si/o\\_zrsz/naslovi\\_in\\_uradne\\_ure](https://www.ess.gov.si/o_zrsz/naslovi_in_uradne_ure)

## QENDRA E KARRIERËS

### ÇFARË

Si pjesë e ZRSZ, qendra e karrierës jep informacion mbi mundësitë e punësimit, këshilla për punësim dhe karrierën e mëtejshme. Ata organizojnë punëtori grupore për të përmirësuar aftësitë e kërkimit të punës dhe, në bashkëpunim me punëdhënësit përfaqësojnë vendet e lira të punës. Në Qendrën e Karrierës, ju keni qasje në mjete për udhëzime profesionale të pavarura, shfletimin e vendeve të lira të punës etj.

### KU

Zyra më e afërt lokale e Qendrës së Karrierës mund të gjendet në faqen e internetit (në gjuhën sllovene):

[https://www.ess.gov.si/o\\_zrsz/naslovi\\_in\\_uradne\\_ure](https://www.ess.gov.si/o_zrsz/naslovi_in_uradne_ure)



## EURES

### ÇFARË

EURES është Portali Evropian i Mobilitetit të Punës. Në faqen e tij të internetit ju mund të shikoni vendet e lira të punës nëpër Evropë. Ju gjithashtu mund të kontaktoni Këshilltarin e EURES në Shërbimin e Punësimit të Sllovenisë për t'ju këshilluar. Vendet e lira të punës për EURES klasifikohen sipas kategorive të ndryshme (zona e punës, vendi, etj.). Ju gjithashtu mund të shkarkoni CV tuaj për punëdhënësit në Evropë.

### KU

- EURES – një ueb portal (i disponueshëm në të gjitha gjuhët evropiane):  
<https://ec.europa.eu/eures/public/en/homepage>
- EURES pranë Entit të Republikës së Sllovenisë për Punësim (në sllovenisht):  
<https://www.ess.gov.si/eures>

## QENDRAT E KARRIERËS NË UNIVERSITETET SLLOVENE

### ÇFARË

Të katër universitetet në Slloveni ofrojnë studentëve të tyre ndihmë për zhvillim profesional. Disa punëdhënës vendet e lira të punës gjithashtu i publikojnë në faqet e tyre të internetit

### KU

- Qendrat e Karrierës në Universitetin e Lubjanës (University of Ljubljana Career Centre)  
Kongresni trg 12, 1000 Ljubljana  
Telefon: +386 1 2418 732  
<http://www.kc.uni-lj.si/domov.html>  
Email: [kc@uni-lj.si](mailto:kc@uni-lj.si)
- Qendrat e Karrierës në Universitetin e Mariborit (University of Maribor Career Centre)  
Slomškov trg 15, 2000 Maribor  
Tel: +386 2 23 55 209  
<https://kc.um.si/o-nas/>  
Email: [karierni.center@um.si](mailto:karierni.center@um.si)





- 
- Qendrat e Karrierës në Universitetin Primorska (University of Primorska Career Centre)  
Čevljarska ulica 27, 6000 Koper  
Telefon: +386 5 611 76 36  
<http://kariernicenter.upr.si/sl/>  
Email: [kariernicenter@upr.si](mailto:kariernicenter@upr.si)
  - Qendrat e Karrierës në Universitetin Nova Gorica (University of Nova Gorica Career Centre)  
Vipavska cesta 13, Rožna Dolina, 5000 Nova Gorica  
Tel: +386 51 336 770  
<http://www.ung.si/sl/karierni-center/>  
Email: [karierni.center@ung.si](mailto:karierni.center@ung.si)
- 

## ENTI YPSILON

### ÇFARË

Ypsilon është një organizatë joqeveritare që lidh të rinjtë. Ata kanë përgatitur një program të mentorimit ku të rinjtë midis moshës 15 dhe 30 vjeç mund të gjejnë një mentor në fushën e tyre të interesit. Faqja e internetit lidh mentorët dhe të rinjtë. Ju mund të rishikoni se kush dëshiron të jetë mentor dhe të lidheni me këtë person për t'ju ndihmuar me zhvillimin e karrierës. Pjesëmarrja është vullnetare dhe pa pagesë për mentorët dhe të rinjtë që kanë nevojë për mentor.

### KU

Më shumë informata janë në dispozicion në faqen e internetit (në anglisht):

<https://www.mentorstvo.si/en/>

---

## ZAVOD NEFIKS

### ÇFARË

Nefix është një strukturë që i ndihmon të rinjtë të regjistrojnë dhe të injektojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për një prezantim të suksesshëm në tregun e punës. Ata drejtojnë programe të ndryshme (të tilla si *talentiran.si* dhe zgjidhjet e punësimit) për të mbështetur të rinjtë në ndërtimin dhe zhvillimin e karrierës së tyre dhe përmirësimin e perspektivave të tyre të punësimit.

### KU



---

Më shumë informata janë në dispozicion në faqen e internetit (në gjuhën sllovene):  
<http://www.nefiks.si/>

---

## **INSPEKTORATI I PUNËS I RS-SË**

### **ÇFARË**

Është një organ administrativ i përbërë nga Ministria e Punës, Familjes, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Mbikëqyrë zbatimin e ligjeve, rregulloreve të tjera, marrëveshjeve kolektive dhe akteve të përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet e punës, pagat dhe shpërblime të tjera nga punësimi.

### **KU**

Inspektorati i Republikës së Sllovenisë për Punë  
Verovškova ulica 64a, 1000 Ljubljana  
Telefon: +386 1 280 36 60  
<http://www.id.gov.si>  
E-mail: [gp.irsd@gov.si](mailto:gp.irsd@gov.si)

---

## **KONSULENCË PËR PUNONJËSIT**

### **ÇFARË**

Është një organizatë që ofron advokim, mbrojtje, promovim dhe zhvillim të të drejtave të punëtorëve, të drejtave sociale dhe ligjore të grupeve të cënueshme si emigrantët.

### **KU**

Konsulencë për punonjësit (Counselling Office for Workers)  
Dalmatinova ulica 4, 1000 Ljubljana  
Telefon: +386 1 434 12 10 and 080 14 34  
<http://www.delavskasvetovalnica.si/>  
Email: [info@delavskasvetovalnica.si](mailto:info@delavskasvetovalnica.si)



---

## ASOCIACIONI I SINDIKATAVE TË LIRË TË SLLOVENISË - ZSSS

### ÇFARË

Qëllimi i kësaj organizate është të negociojë përmbajtjen e marrëveshjeve kolektive dhe të bashkëpunojë në harmonizimin e projektligjeve dhe dokumenteve të tjera që kanë të bëjnë me punëtorët.

### KU

Asociacioni i Sindikatave të Lirë të Sllovenisë – ZSSS (Association of Free Trade Unions of Slovenia)

Dalmatinova ulica 4, 1000 Ljubljana

Telefoni: +386 1 434 12 00

<https://www.zsss.si>

Email: [zsss@sindikat-zsss.si](mailto:zsss@sindikat-zsss.si)

## Punësim praktik

---

### ÇFARË

Punësimi praktik është një formë e veçantë e një programi të arsimit të mesëm profesional në shkollat e mesme profesionale, ku mësimin teorik (50%) e kombinoni me trajnime praktike në vendin e punës (50%). Pjesa teorike e programit trevjeçar zhvillohet në shkollë dhe pjesa praktike është në një kompani të zgjedhur nga nxënësi.

Praktikanti punon së bashku me një mentor dhe mëson të kryej punën siç duhet, mirëpo ai nuk është i punësuar në kompani, por punon sipas kontratës së ashtuquajtur të praktikës. Punëdhënësi merr përsipër t'i paguajë nxënësit një kompensim mujor financiar për punën që ai/ajo kryen.

Programi i praktikës ju mundëson të jeni aktivisht, gjatë shkollimit, i përfshirë në procesin e punës, që sa më shpejt të kualifikoheni për profesionin dhe kalimin sa më të lehtë nga shkolla në punë.



---

## KUSH

Nxënësit që duan të mësojnë se si të ndjekin një profesion të caktuar dhe që regjistrohen në një shkollë të mesme profesionale dhe teknike trevjeçare, ku zgjedhin programin e praktikës.

---

## SI

Së pari ju duhet të regjistroheni në një nga shkollat e mesme profesionale dhe teknike dhe të zgjidhni formën e programit ku dëshironi të shkolloheni. Keni dy mundësi: një program i rregullt (i cili nuk përfshin praktikën) dhe programi i praktikës.

Këtu është një listë e shkollave që ofrojnë programin e praktikës (në sllovenisht):  
<https://www.gzs.si/vajenistvo/vsebina/VAJENI%C5%A0TVO/Vklju%C4%8Dene-%C5%A1ole>

Ju gjithashtu duhet të kërkonit për një kompani në të cilën do të kryeni praktiken si pjesë e programit tuaj të arsimit dhe të nënshkruani një kontratë praktike me këtë kompani. Kompanitë që ofrojnë një program praktike duhet të regjistrohen në Ministrinë e Arsimit. Lista e kompanive të regjistruara është në dispozicion këtu:  
<https://www.gzs.si/vajenistvo/vsebina/VAJENCI-Informacije-za-vajence-in-njihove-sar%C5%A1e/Seznam-podjetij-vklju%C4%8Denih-v-vajeni%C5%A1tvo>

---

## KUR

Kërkesa për regjistrim në një program të mësimin në shkollën e mesme profesionale dhe teknike duhet të dorëzohet brenda afatit të specifikuar kohor. Zakonisht, afati i fundit për aplikim është në mars, për vitin e ardhshëm shkollor.

---

## MIRË ËSHTË TA DINI



---

Në vitin shkollor 2017/2018, programi i praktikës është në fazën e testimit, kështu që zgjedhja e një vargu të caktuar profesioneve varet nga rajoni në të cilin ndodhet shkolla juaj.

---

## KU

Më shumë informacion në lidhje me programin e praktikës mund të merrni direkt në shkollat e mesme profesionale dhe teknike që ofrojnë këtë program. Lista e shkollave është në dispozicion këtu:

<https://www.gzs.si/vajenistvo/vsebina/VAJENI%C5%A0TVO/Vklju%C4%8Dene-%C5%A1ole>

Informacioni për programin e praktikës është gjithashtu në dispozicion pranë Odes ekonomike të Sllovenisë (në sllovenisht): <https://www.gzs.si/vajenistvo>

Oda ekonomike e Sllovenisë

Dimičeva 13

1504 Ljubljana

Tel.: 386 1 5898 000

<https://www.gzs.si/>

Email: [info@gzs.si](mailto:info@gzs.si)

Për informacion kontaktoni: Tel.: +386 1 58 98 531



## Kërkim i një vendi pune

### MIRË ËSHTË TA DINI

Kur një agjenci vlerëson se ju jeni zgjedhja e duhur për një punë të caktuar, ju nënshkruani një kontratë punësimi, zakonisht për një periudhë të caktuar kohore. Zyrtarisht, punëdhënësi juaj është kjo agjenci punësimi, por ju keni të njëjtat të drejta si punëtorët e tjerë të punësuar drejtpërdrejt me përdoruesin (kompania ku ju punoni në të vërtetë). Agjencia e punësimit, pa vendosur ndonjë kufizim, duhet t'ju lejojë që pas skadimit të marrëveshjes me agjencinë, të lidhni një marrëdhënie pune direkt me kompaninë. Sidoqoftë, punëdhënësi është i detyruar t'ju informojë për vendet e lira të punës dhe të ofrojë mundësi të barabarta për punësim për një periudhë të pacaktuar kohore siç punonjësit e tjerë të punësuar aty.

### ENTI I REPUBLIKËS SË SLOVENISË PËR PUNËSIM

#### ÇFARË

Enti i Republikës së Sllovenisë për Punësim është institucioni qendror shtetëror që i ndihmon punëkërkuarit të kërkojnë punë dhe u ofron atyre punë të ndryshme. Nëse jeni të papunë, ju mund të regjistroheni si të papunë, me kusht që ju jeni në gjendje për të kryer punë dhe në mënyrë aktive në kërkim të një pune në Slloveni dhe jeni të gatshëm për të pranuar një punë të ofruar nga këshilltari juaj për punësim. Ju mund të aplikoni në zyrën tuaj lokale ose në ndonjë zyrë tjetër për punë duke paraqitur një dokument personal me fotografi (letërnjoftim, pasaportë, leje qëndrimi). Aty do ju caktohet një këshilltar personal punësimi, i cili do t'ju ndihmojë të gjeni punë dhe në zhvillimim e karrierës ku gjithashtu ju informojë për ofertat aktuale të punës.

#### KU

Më shumë informacion në anglisht mund të gjeni këtu (<http://ess.gov.si/>) gjithashtu mund të kontaktoni edhe personalisht degën më të afërt e Entit për Punësim –



---

Lista e kontakteve dhe adresave: <https://www.ess.gov.si/kontakt>

---

## **QENDRA KOMBËTARE E INFORMACIONIT DHE KONSULENCËS PËR KARRIERËN TUAJ PRANË ENTIT TË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR PUNËSIM**

### **ÇFARË**

Qendrat e karrierës janë pjesë e Entit të Republikës së Sllovenisë për Punësim. Ato ofrojnë informacion mbi mundësitë e punësimit, këshillimin për karrierën dhe udhëzimet për karrierë gjatë gjithë jetës. Aty organizojnë punëtori grupore për të përmirësuar aftësitë e kërkimit të punës dhe, në bashkëpunim me punëdhënësit, ofrojnë oferta aktuale të punës. Në Qendrën e Karrierës ju keni qasje në mjete për udhëheqje të pavarur të karrierës dhe mund të rishikoni ofertat për punë.

### **KU**

Qendra e Karrierës, Enti i RS-së për Punësim – ZRSZ – lista e kontakteve dhe adresave: <https://www.ess.gov.si/kontakt>

---

## **"GJENI NJË PUNË"**

### **ÇFARË**

Gjeni një punë është portali zyrtar i Entit të Republikës së Sllovenisë për Punësim, ku mund të shqyrtohen ofertat e punës. Portali është në dispozicion për personat e papunë të regjistruar dhe punëkërkues të tjerë. Për të pasur qasje në të, duhet të regjistroheni. Ju mund të vendosni kriteret e kërkimit (lokacioni, niveli i kërkuar i arsimit, ndryshimet, etj.) Në mënyrë që të shfletoni lehtësisht vendet e lira të punës. Portali ofron komunikim me Këshilltarin e Punësimit në Entin e Punësimit të Sllovenisë. Nëse dëshironi, ju mund ta ngarkoni CV-në tuaj në portal, i cili më pas është i disponueshëm për punëdhënësit në Slloveni, duke rritur kështu mundësitë për gjetjen e punës tuaj.

### **KU**

<https://www.poiscidelo.si/>



---

## ADECCO

### ÇFARË

Një agjenci private e punësimit që ju lidh me punëdhënësit që aktualisht kërkojnë punëtorë. Ju mund të regjistroheni në regjistrin e kërkimit të punës dhe pastaj ta dërgoni një CV ose ta vizitoni atë për një intervistë. Kur agjencia mendon se jeni personi i duhur për një vend pune të caktuar, mund të nënshkruani një kontratë punësimi, zakonisht për një kohë të caktuar. Zyrtarisht, punëdhënësi juaj është kjo agjenci punësimi. Për shërbimet e tyre ju paguani një tarifë.

### KU

Më shumë informacion në lidhje me agjencinë e punësimit keni në dispozicion në <http://www.adecco.si>.

---

## MANPOWER

### ÇFARË

Një agjenci private e punësimit që ju lidh me punëdhënësit që aktualisht lërkojnë punëtorë. Ju mund të regjistroheni në regjistrin e kërkimit të punës dhe pastaj ta dërgoni një CV ose ta vizitoni atë për një intervistë. Kur agjencia mendon se jeni personi i duhur për një vend pune të caktuar, mund të nënshkruani një kontratë punësimi, zakonisht për një kohë të caktuar. Zyrtarisht, punëdhënësi juaj është kjo agjenci punësimi. Për shërbimet e tyre ju paguani një tarifë.

### KU

Më shumë informacion në lidhje me Agjencinë e Punësimit mund të gjendet në faqen e internetit në vijim:

[https://candidate.manpower.com/wps/portal/SICampus/Slovenia-Jobs/Search-Jobs!/ut/p/a1/dY1NC4JAGIR\\_iwewvm9-LNFtI8oCNdBK9xIK6yrKrqxb\\_v0sugg1l2GGZxhgkAOT5bMVpWmVLpt3ZuS-32ZhlKUeJvGZ4BHRv9DQxdnhBmyJHEi6Q\\_caBysvIYgJ-QL4RxThBEz0qvrCFVRW3loA07zmmmvnoee6MWYYNzbaOE2TI5QSPXfG1sZfi0aNBvIFCCmXMHRdHZmg8qllvQAUKILI/dI5/d5/L0IHskovd0RNQU5rQUVnQSEhLzRKU0Uvc2w/!](https://candidate.manpower.com/wps/portal/SICampus/Slovenia-Jobs/Search-Jobs!/ut/p/a1/dY1NC4JAGIR_iwewvm9-LNFtI8oCNdBK9xIK6yrKrqxb_v0sugg1l2GGZxhgkAOT5bMVpWmVLpt3ZuS-32ZhlKUeJvGZ4BHRv9DQxdnhBmyJHEi6Q_caBysvIYgJ-QL4RxThBEz0qvrCFVRW3loA07zmmmvnoee6MWYYNzbaOE2TI5QSPXfG1sZfi0aNBvIFCCmXMHRdHZmg8qllvQAUKILI/dI5/d5/L0IHskovd0RNQU5rQUVnQSEhLzRKU0Uvc2w!/)





---

## TRENKWALDER

### ÇFARË

Një agjenci private e punësimit që ju lidh me punëdhënësit që aktualisht lërkojnë punëtorë. Ju mund të regjistroheni në regjistrin e kërkimit të punës dhe pastaj ta dërgoni një CV ose ta vizitoni atë për një intervistë. Kur agjencia mendon se jeni personi i duhur për një vend pune të caktuar, mund të nënshkruani një kontratë punësimi, zakonisht për një kohë të caktuar. Zyrtarisht, punëdhënësi juaj është kjo agjenci punësimi. Për shërbimet e tyre ju paguani një tarifë.

### KU

Më shumë informacion në lidhje me Agjencinë e Punësimit mund të gjendet në faqen e internetit në vijim:

<https://si.trenkwaldner.com/>

---

## KARIERA

### ÇFARË

Një agjenci private e punësimit që ju lidh me punëdhënësit që aktualisht lërkojnë punëtorë. Ju mund të regjistroheni në regjistrin e kërkimit të punës dhe pastaj ta dërgoni një CV ose ta vizitoni atë për një intervistë. Kur agjencia mendon se jeni personi i duhur për një vend pune të caktuar, mund të nënshkruani një kontratë punësimi, zakonisht për një kohë të caktuar. Zyrtarisht, punëdhënësi juaj është kjo agjenci punësimi. Për shërbimet e tyre ju paguani një tarifë.

### KU

Më shumë informacion në lidhje me Agjencinë e Punësimit mund të gjendet në faqen e internetit në vijim:

<https://www.kariera.si/deloiskalci/>

---

## KARIERNI PORTAL OPTIUS.COM

### ÇFARË



---

Një portal për punësim ku mund të gjeni konkurse të përditësuara për punë.

KU

[www.optius.com](http://www.optius.com)

---

## **PUNËSIMI IM**

ÇFARË

Një treg pune online ku mund të gjeni konkurse të përditësuara për punë.

KU

<https://www.mojazaposlitev.si/>

---

## **EURES**

ÇFARË

EURES është një portal evropian për mobilitetin e Punës. Në këtë faqe të internetit ju mund të shikoni konkurse për punë në të gjithë Evropën. Konkursset për punë në EURES klasifikohen sipas kategorive të ndryshme (zona e punës, vendi, etj.). Ju gjithashtu mund ta shkarkoni CV-në tuaj në këtë portal, i cili më pas është në dispozicion për të gjithë punëdhënësit në Evropë. Me ndihmën e Entit të Punësimit të Sllovenisë, ju gjithashtu mund të kontaktoni këshilltarin EURES për t'ju ndihmuar të gjeni punë në vendet anëtare të BE-së dhe t'ju ofrojë informacion mbi kushtet e jetesës dhe punës në vendin e zgjedhur. Ai gjithashtu do t'ju lidhë me këshilltarin EURES në këtë vend, i cili do t'ju ofrojë më shumë informacion.

KU

Faqja e internetit EURES është në dispozicion në të gjitha gjuhët evropiane.

<https://ec.europa.eu/eures/public/sl/homepage>

Këshilltari për portalin EURES pranë Entit të RS-së për punësim: <https://www.ess.gov.si/eures>



Entit i Republikës së Sllovenisë për Punësim – lista e kontakteve dhe adresave:  
(në sllovenisht): <https://www.ess.gov.si/kontakt>

## Statusi i peshkatarit – personi fizik

### ÇFARË

Ky është një status i veçantë që mund të merret në qoftë se doni të angazhoheni në peshkimin tregtar në det. Me këtë status ju hyni në regjistrin e peshkatarëve – personave fizikë. Jeni të trajtuar si të keni statusin e një mbajtësi të fermës, në lidhje me pensionin, invaliditetin dhe sigurimin shëndetësor.

### HAPI

HAPI 1: Për të fituar statusin, verifikoni nëse plotësoni kushtet e mëposhtme:

- nuk jeni pronar ose bashkëpronar i një biznesi;
- nuk jeni i regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve të pavarur;
- nuk merrni pension;
- aktiviteti juaj ekskluziv është peshkimi komercial.

HAPI 2: Nëse plotësoni kushtet, dorëzoni kërkesën dhe dokumentet mbështetëse (deklaratën që i plotësoni kushtet ose që në ditën që dëshironi të fitoni statusin e personave fizikë nuk do të jeni sipërmarrës i pavarur). Kërkesën tuaj dorëzoni pranë Ministrisë të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit, me postë ose personalisht. Ju gjithashtu mund të dorëzoni një kërkesë elektronike përmes faqes së internetit (vetëm në gjuhën sllovene):

<https://e-uprava.gov.si/podrocja/vloge/vloga.html?id=2458> , nëse keni një certifikatë dixhitale dhe një nënshkrim elektronik.

HAPI 3: Nëse jeni S.P. (kontrolloni “sipërmarrë i pavarur – vetëpunësim” në Danub



---

Compass), ju duhet të nxirreni nga Regjistri i Bizneseve pasi të merrni një vendim për regjistrimin në regjistrin e peshkatarëve – personave fizikë. Vendimi do të nxjerret nga Ajpes.

HAPI 4: Ju duhet të siguronit një kopje të vendimit të Ajpes së bashku me vendim e Ministrisë, vërtetimin e aftësisë shëndetësore dhe cenazsin financiar të arritur në Institutin e Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë.

---

## KU

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit

Dunajska cesta 22, 1000 Ljubljana

Telefoni: +386 1 478 00 00

[http://www.mkgp.gov.si/si/delovna\\_podrocja/ribistvo/morski\\_ribolov/pridobitev\\_statusa\\_ribica/](http://www.mkgp.gov.si/si/delovna_podrocja/ribistvo/morski_ribolov/pridobitev_statusa_ribica/)

Email: [gp.mkgp@gov.si](mailto:gp.mkgp@gov.si)

Më shumë informacion mbi statusin e peshkatarit:

(në

sllovenisht): <http://evem.gov.si/info/podpogoj/drugiPogoj/14605/prikaziDrugiPogoj/>

/

(në

sllovenisht): <https://e-uprava.gov.si/podrocja/kmetijstvo-gozdarstvo-prehrana/divjad-lovstvo-ribolov/morski-gospodarski-ribic.html>

(në

sllovenisht): [http://www.mkgp.gov.si/si/delovna\\_podrocja/ribistvo/morski\\_ribolov/pridobitev\\_statusa\\_ribica/](http://www.mkgp.gov.si/si/delovna_podrocja/ribistvo/morski_ribolov/pridobitev_statusa_ribica/)



---

# Fermer

---

## ÇFARË

Ky është një status i veçantë që mund të merret nëse jeni të angazhuar në një aktivitet bujqësor, jeni të kualifikuar për të punuar në bujqësi dhe mund të provoni se mund të gjeneroni një fitim të caktuar me aktivitetin bujqësor. Me këtë status, ju keni të drejtën e përparësisë për të blerë tokë bujqësore ose fermë, dhe në disa raste edhe ju keni të drejtë për një përjashtim tatimor.

Më shumë informacion mbi statusin e një fermeri mund të gjeni në faqen e internetit

- e-Administrata

<https://e-uprava.gov.si/si/podrocja/kmetijstvo-gozdarstvo-prehrana/kmetijske-dejavnosti/status-kmeta>

dhe

- E-SPOT <http://evem.gov.si/info/poslujem/zaposlovanje/pogodba-o-zaposlitvi-in-postopek-zaposlitve/prijava-v-obvezna-socialna-zavarovanja/prijava-v-obvezna-socialna-zavarovanja-kmetov/>

---

## KUSH

Për të marrë statusin e fermerit, duhet të plotësoni një nga kushtet e mëposhtme:

- Nëse jeni pronar, qiramarrës ose përdoruesi tjetër i tokës bujqësore, e punoni këtë tokë vetë ose me ndihmën e të tjerëve, dhe për këtë punë jeni të trajnuar në mënyrë të përshtatshme,
- nëse jeni anëtar i familjes së një personi nga paragrafi i mëparshëm, nëse kryeni një aktivitet bujqësor në fermë si aktiviteti i vetëm ose kryesor dhe jeni të trajnuar siç duhet,



- nëse ju keni fituar një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave tuaja nga aktivitetet bujqësore në fermë, por për shkak të moshës ose aftësisë së kufizuar, nuk angazhoheni më në këtë veprimtari bujqësore, nëse kujdeseni për përpunimin e tokës bujqësore,
- nëse jepni një deklaratë në procesverbal në njësinë administrative, që ju vetë ose me ndihmën e të tjerëve, kultivoni tokën bujqësore për të cilën tregoni që në bazë të kësaj pune do të fitoni një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave nga aktiviteti bujqësor nga këto toka dhe të plotësoni kërkesat e kualifikimit.

## SI

Kërkesën me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzoni në njësinë administrative ku është regjistruar prona juaj bujqësore.

Nëse keni një certifikatë dixhitale dhe një nënshkrim elektronik, ju mund të dorëzoni aplikacionin elektronik në

e-Uprava <https://e-uprava.gov.si/podrocja/vloge/vloga.html?id=417>

## KU

Për statusin e fermerit mund të aplikoni në njësinë administrative: <http://www.upravneenote.gov.si>

Autoriteti kompetent për regjistrimin e statusit të fermerit është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit:

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit

Dunajska cesta 022

1000 Ljubljana

Tel.: +386 1 478 90 00

<http://www.mkgp.gov.si/en/>

Email: [gp.mkgp@gov.si](mailto:gp.mkgp@gov.si)





---

## Format e përshtatura të punës

---

### MIRË ËSHTË TA DINI

Si student, ju keni të njëjtat të drejta si punëtorët e tjerë (pushimet, festa, numri maksimal i orëve të lejuara në ditë). Ju jeni gjithashtu të siguruar në kuadër të sigurimit pensional dhe invalidor. Kjo do të thotë se periudha e kryerjes së punës studentore ju llogaritet në periudhën pensionale në regjistrin e sigurimeve pensionale dhe invalidore. Punëdhënësi juaj gjithashtu duhet të ju siguroj për rast aksidenti në punë.

---

### KONTRATË PËR KOHË TË CAKTUAR

#### ÇFARË

Kontrata e punësimit me afat të caktuar është e kufizuar në kohë. Ajo mund të nënshkruhet për një maksimum prej dy vjetësh, qoftë për orar të plotë ose për punën me kohë të pjesshme. Kohëzgjatja zakonisht përbëhet nga 40 orë në javë, por jo më pak se 36 orë në javë. Puna me orar të pjesshëm mbulon më pak se 36 orë në javë.

Ju keni të njëjtat të drejta si punëtorët që punojnë nën një kontratë me kohë të pacaktuar.

Punëdhënësi duhet t'ju regjistrojë në sistemin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror në të njëjtën ditë kur filloni të punoni.

---

### MARRËVESHJE KONTRAKTUALE

#### ÇFARË

Ju nënshkruani një "Marrëveshje Kontratash" kur ju punësojnë për të kryer një punë ose një shërbim të caktuar. Fusha e veprimit, periudha gjatë së cilës duhet të përfundojë puna, numri i orëve në javë, ndryshimet dhe detajet e tjera





---

(cilësia/sasia e punës së kryer, shërbimi apo produkti) janë të përcaktuara në kontratë. Kur punoni në përputhje me këtë kontratë, ju konsideroheni të vetëpunësuar.

Marrëveshja kontraktuale nuk mbulon sigurimin në rast të papunësisë ose sigurimin e pensioneve. Pas përfundimit të kontratës, nuk mund të kërkonte kompensime për papunësi ose pensione.

---

## **MARRËVESHJA E AUTORIT**

### **ÇFARË**

Kjo lloj kontrate ju lejon të punësoheni si një autor i cili krijon një punë origjinale të mbrojtur me të drejtën e autorit (forma të ndryshme të shprehjes artistike, punë shkencore dhe forma të tjera të veprimit të autorit).

Shtirja e punës, periudha gjatë së cilës duhet të përfundojë puna, numri i orëve në javë dhe detaje të tjera (cilësia /sasia e punës së kryer, shërbimi apo produkti) janë të përcaktuara në kontratë. Kur punoni në përputhje me këtë kontratë, ju konsideroheni të vetëpunësuar.

Marrëveshja e autorit nuk mbulon sigurimin në rast të papunësisë ose sigurimin e pensioneve. Pas përfundimit të kontratës, nuk mund të kërkonte kompensime për papunësi ose pensione.

---

## **PUNË PLOTËSUESE PERSONALE**

### **ÇFARË**

Nëse dëshironi të kryeni punë të rastit, si ndihma familjare, vepra artizanale etj, ju mund të regjistroni biznesin tuaj personal plotësues në njësinë administrative. Ju mund të kryeni punën plotësuese edhe nëse jeni një i punësuar i rregullt ose nëse jeni i papunë, pensionist ose student. Nëse nuk jeni shtetas slloven, mund të kryeni punën plotësuese personale vetëm nëse keni qasje të lirë në tregun e punës.



Para se të filloni, duhet të merrni një të ashtuquajtur vlerësim që e blini në njësinë administrative për veten ose klientin tuaj. Vlerësimi është i vlefshëm për një muaj, mund të lëshohet për muajin aktual ose të ardhshëm.

Të ardhurat gjysmëvjetore të krijuara nga puna plotësuese personale nuk mund të kalojnë shumë prej tre pagave mesatare në Slloveni të vitit të mëparshëm kalendarik.

## **PUNA STUDENTORE**

### **ÇFARË**

Gjatë kohës së shkollimit në Slloveni ju mund të kryeni punë të përkohshme studentore ose punë studentore me orarë të shkurtër. Puna studentore mund të bëhet kur jeni 15 vjeç e më shumë dhe jeni regjistruar në një program të arsimit të mesëm ose të lartë.

Nëse jeni shtetas i një Shteti Anëtar të BE-së ose një vendi jo anëtar të BE-së, ju mund të kryeni punë studentore nëse jeni duke studiuar në Slloveni ose duke marrë pjesë në një program ndërkombëtar të shkëmbimit të studentëve. Ju gjithashtu duhet të keni:

- një dokument të vlefshëm identiteti,
- një llogari bankare sllovene,
- numrin personal tatimor të Sllovenisë,
- dëshmi që jeni student në Slloveni – një provë e regjistrimit në një fakulltet ose universitet në Slloveni.

Së pari, ju duhet të regjistroheni në një Shërbim studentor ku mund të rishikoni konkurset për punën e studentëve. Punoni në bazë të një kontrate të veçantë, e cila referohet si udhëzim. Këtë udhëzim e merrni në Shërbimin e studentëve. Ka më shumë se 25 shërbime të ndryshme studentore në të gjithë Slloveninë.

Më shumë rreth punës së studentëve mund të lexoni këtu

(në sllovenisht): <http://www.studentska-org.si/studentski-kazipot/studentsko-delo/>

(në anglisht): <http://studyinslovenia.si/live/working/>



---

## PUNA SEZONALE

### ÇFARË

Puna sezonale është një punë e përkohshme dhe e rastësishme që lidhet me një sezon të caktuar dhe zgjat një periudhë të caktuar varësisht nga puna (p.sh. bujqësi, pylltari, turizëm, ndërtimtari). Ju jeni një punëtor sezonal kur punoni në një punë individuale në bazë të një kontrate të lidhur (kontratë pune me afat të caktuar, marrëveshje kontraktuale). Pas skadimit të kontratës, nuk keni të drejtë dëmshpërblimi, por mund të llogarisni kohën e punës që konsiderohet si një periudhë e punës. Të huajt mund të punojnë vetëm në bujqësi dhe pylltari dhe para kësaj ata duhet të marrin një leje pune të përshtatshme dhe leje qëndrimi.



---

# I vetëpunësuar në kulturë

---

## ÇFARË

Kjo është një formë e kryerjes së pavarur të një aktiviteti kulturor që mund të merret nëse jeni krijues në fushën e kulturës dhe artit duke regjistruar si i vetëpunësuar në kulturë pranë Ministrisë së Kulturës.

Më shumë për marrjen e këtij statusit mund të lexoni në faqen e internetit të Ministrisë së Kulturës

(në sllovenisht):

[http://www.mk.gov.si/si/storitve/postopki/statusi\\_in\\_pravice/vpis\\_v\\_razvid\\_samoz\\_aposlenih/](http://www.mk.gov.si/si/storitve/postopki/statusi_in_pravice/vpis_v_razvid_samoz_aposlenih/)

---

## KUSH

Vetëpunësuar në kulturë janë krijues në fushën e kulturës që kryejnë një profesion të specializuar të pavarur në fushën e kulturës. Në regjistrin e personave të vetëpunësuar në kulturë pranë Ministrisë së Kulturës, mund të regjistroheni nëse plotësoni kushtet e mëposhtme:

---

## SI

Ju mund të dorëzoni një kërkesë për regjistrim në regjistrin e të vetëpunësuarve në kulturë pranë Ministrisë së Kulturës.

---

## MIRË ËSHTË TA DINI

Të vetëpunësuarit në kulturë, në kushte të veçanta, mund të aplikojnë për njohjen e të drejtës për pagesë të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Kërkesë për njohjen e së drejtës për pagesë të kontributeve mund të dorëzoni pranë Ministrisë së Kulturës.



---

## KU

Më shumë informacion mbi statusin e të vetëpunësuarve në kulturë mund të gjenden në Ministrinë e Kulturës.

Ministria e Kulturës  
Maistrova ulica 10  
1000 Ljubljana

Tel.: +386 1 369 59 00  
<http://www.mk.gov.si/si/>  
Email: [gp.mk@gov.si](mailto:gp.mk@gov.si)

Nëse keni certifikatë dixhitale ose nënshkrim elektronik, gjithashtu mund të regjistroheni përmes portalit të mëposhtëm (në gjuhën sllovene): E-Administrata:  
<https://e-uprava.gov.si/>



---

## Biznes pasditor/plotësues s. p.

---

### ÇFARË

Në Slloveni, punësimi me orar të plotë mund të kombinohet me vetëpunësim duke regjistruar një biznes pasditor/plotësues të ndërmarrësit të pavarur. Kjo do të thotë që ju mund të jeni të punësuar (në një kompani që paguan kontributet tuaja të sigurimeve shoqërore dhe taksat), por në të njëjtën kohë ju kryeni aktivitete të pavarura të biznesit jashtë orarit normal të punës. Statusi ligjor, të drejtat dhe detyrat e një ndërmarrësi të pavarur për punën pasditore/plotësuese janë të njëjta si për ndërmarrësin e pavarur të zakonshëm. Diferenca është në nivelin e kontributeve të paguara.

---

### KUSH

Biznes pasditor/plotësues të s. p. ju mund të aplikoni nëse jeni të punësuar me orar të plotë me një kompani të caktuar (40 orë në javë). Nëse jeni i punësuar me orarë të pjesshëm ose nëse jeni student ose pensionist, nuk mund të aplikoni.

---

### SI

Mënyra më e lehtë për të regjistruar biznesin tuaj është një aplikim elektronik në portalin e-SPOT, i cili është portal kombëtar për subjektet afariste. Ju gjithashtu mund ta aplikoni personalisht në njërin nga pikat SPOT.

Për të përfunduar procesin e regjistrimit, do t'ju duhet një dokument i vlefshëm identifikimi dhe një numër tatimor.

Procesi përbëhet nga tre hapa:

- Biznesin e regjistroni në Regjistrin e Bizneseve të Sllovenisë (formulari Ajpes),



- Në lidhje me regjistrimin informoni Administratën Financiare (formulari FURSD), në formular shënoni që sigurimet do të paguhen nga një burim tjetër,
- Duhet të bëni sigurimin në rast aksidentesh dhe sigurimin për raste sëmundjesh profesionale (formulari M12).

## MIRË ËSHTË TA DINI

Nëse koha juaj e punës si ndërmarrës tejkalon 40 orë në muaj, do t'ju kërkohet të paguani kontributet e sigurimeve shoqërore (pension, paaftësi, sigurim shëndetësor dhe sigurim papunësie) si dhe shpenzimet e kontabilitetit dhe menaxhimit të një llogarie bankare. Për disa aktivitete të specializuara, ju duhet të dorëzoni certifikata apo licenca specifike (për shembull, për aktivitete ushqimore ose shëndetësore). Për më shumë informacion mbi lejet dhe licencat, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të pikës së vetme kontaktuese për subjektet e biznesit të huaj Slovenian Business Point (në anglisht): <http://eugo.gov.si/>

## KU

Si sipërmarrës i pavarur pasditor/plotësues, më së lehti do të regjistroheni me një kërkesë elektronike në portalin kombëtar e-SPOT për personat komercialë, personalisht në pikat e SPOT në të gjithë Slloveninë.

- Portali i internetit  
e-SPOT: <http://eSPOT.gov.si/info/zacenjam/zelim-ustanoviti-podjetje/>
- Lista e pikave SPOT në të gjithë  
Slloveninë: <http://eSPOT.gov.si/info/SPOT-tocke/>

## KUJDES

Si sipërmarrës i pavarur, ju jeni personalisht përgjegjës për të gjitha aktivitetet dhe borxhet e kompanisë suaj.







## Kontratë për kohë të pacaktuar

### ÇFARË

Kontratë për një periudhë të pacaktuar të punësimit do të thotë që në këtë kontratë data e skadimit ose të ndërprerjes së punësimit nuk është e caktuar. Kontrata duhet të përfshijë kushtet, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat e punonjësit dhe punëdhënësit. Aty gjithashtu duhet të përmbajë një dispozitë për orarin e punës, për të cilin duhet të bien dakord punëdhënësi dhe punëmarrësi. Puna e caktuar me kontratë mund të kryhet orarë të plotë ose me kohë të pjesshme. Puna me orar të plotë zakonisht përbëhet nga 40 orë në javë, por jo më pak se 36 orë në javë. Puna me orar të pjesshëm mbulon më pak se 36 orë në javë. Një punëtor me kohë të pjesshme ka të njëjtat të drejta dhe detyra si një punonjës me kohë të plotë.

### KUSH

Çdokush që është 15 vjeç ose më i vjetër. Qytetarët e BE-së, ZEE-së dhe Zvicrës kanë të njëjtat të drejta për punësim si qytetarët sllovenë.

Nëse jeni shtetas i një vendi të tretë, ju duhet të keni një leje të vlefshme qëndrimi dhe pune që duhet ta rregulloni para ardhjes tuaj në Slloveni ose ju duhet të keni të drejtën për qasje të lirë në tregun e punës. Në faqen në vijim mund të gjeni se kush kualifikohet për qasje të lirë në tregun e punës

(në sllovenisht):

[https://www.ess.gov.si/delodajalci/zaposlovanje\\_in\\_delo\\_tujcev/prost\\_dostop\\_na\\_trg\\_dela](https://www.ess.gov.si/delodajalci/zaposlovanje_in_delo_tujcev/prost_dostop_na_trg_dela)

(në anglisht):

[http://english.ess.gov.si/jobseekers/free\\_access\\_to\\_the\\_slovenian\\_labour\\_market](http://english.ess.gov.si/jobseekers/free_access_to_the_slovenian_labour_market)

Qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe qytetarët e Kroacisë duhet të marrin një leje pune.



## SI

Para se të filloni të punoni, punëdhënësi duhet të organizojë një ekzaminim mjekësor tek mjeku, i cili është specialist i mjekësisë profesionale, për të siguruar që ju fizikisht jeni në gjendje të kryeni punën. Punëdhënësi, tri ditë para nënshkrimit të kontratës së punës duhet t'ju ofrojë një propozim kontratë pune, në mënyrë që të keni kohë të mjaftueshme për të lexuar me kujdes kushtet e kontratës që përmban kontrata.

## MIRË ËSHTË TA DINI

Kontrata e punës duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Të dhënat e kompanisë dhe të punonjësit (emri dhe adresa),
- titullin e vendit të punës dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi,
- ditën e fillimit të punës,
- vendndodhjen e punës,
- deklarata e kohëzgjatjes së kontratës: kohë e pacaktuar (nëse është kontratë me afat të caktuar, duhet të tregohet data e përfundimit të kontratës);
- një deklaratë nëse është punë me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, ose punë me turne,
- informacion mbi pagën dhe kur paguhet,
- të drejtën për pushim vjetor,
- periudhë njoftimi në rast të ndërprerjes së kontratës,
- kushtet e marrëveshjeve kolektive.

## KUJDES

Punëdhënësi duhet t'ju regjistrojë në sistemin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror në të njëjtën ditë kur filloni punën.





---

## Sipërmarrës i pavarur S.P.

---

### ÇFARË

Ju jeni një sipërmarrës i pavarur kur drejtoni biznesin tuaj si individ, dhe nga ky biznes ju e fitoni pagën tuaj. Ju mund të mbani të gjitha të ardhurat e këtij biznesit, por së pari duhet të paguani tatimin. Nuk ju nevojitet asnjë kapital fillestar.

---

### KUSH

Të drejtën e vetëpunësimit e keni nëse jeni 18 vjeç ose më shumë. Nëse jeni shtetas i një vendi tjetër nga një Shtet Anëtar i BE-së, mund të regjistroheni si një person i vetëpunësuar pas një viti qëndrim ligjor (dhe panderprerë) në Slloveni. Vetëm gjendja e mësipërme e banimit nuk vlen nëse në regjistrin e biznesit jeni të regjistruar si person me profesion të pavarur profesional.

---

### SI

Biznesin tuaj më së lehti mund ta regjistroni përmes e-kërkesës në portalin kombëtar e-SPOT për personat komercialë ose personalisht në pikat e SPOT në të gjithë Slloveninë. Këshilltarët e SPOT do t'ju ndihmojnë me procesin e aplikimit. Për të përfunduar procesin e regjistrimit, do t'ju duhet një dokument i vlefshëm identifikimi dhe një numër tatimor.

Procesi përbëhet nga tre hapa:

- Biznesin e regjistroni në Regjistrin e Bizneseve të Sllovenisë (formulari Ajpes),
- Në lidhje me regjistrimin informoni Administratën Financiare (formulari FURSD),
- Pranë Institutit të Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë dorëzoni kërkesën (formulari M1) për regjistrim në sistemin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror



(pension, invaliditeti, sigurimi shëndetësor dhe sigurimi i papunësisë).

## MIRË ËSHTË TA DINI

Për disa aktivitete të specializuara, ju duhet të dorëzoni certifikata apo licenca specifike (për shembull, për aktivitete ushqimore ose shëndetësore). Për më shumë informacion mbi lejet dhe licencat, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të pikës së vetme kontaktuese për subjektet e biznesit të huaj Slovenian Business Point (në anglisht): <http://eugo.gov.si/>

## KU

Si sipërmarrës i pavarur, më së lehti do të regjistroheni me një kërkesë elektronike në portalin nacional e-SPOT për personat komercialë, personalisht në pikat e SPOT në të gjithë Slloveninë.

- Portali i internetit  
e-SPOT: <http://eSPOT.gov.si/info/zacenjam/zelim-ustanoviti-podjetje/>
- Lista e pikave SPOT në të gjithë  
Slloveninë: <http://eSPOT.gov.si/info/SPOT-tocke/>

## KUJDES

Si sipërmarrës i pavarur, ju jeni personalisht përgjegjës për të gjitha aktivitetet dhe borxhet e kompanisë suaj.

## Punësimi i qytetarëve të BE/ZEE-së dhe qytetarëve të Zvicrës

## ÇFARË

Qytetarët nga BE-ja, ZEE-ja dhe Zvicra kanë qasje të lirë në tregun e punës në



---

Siloveni dhe mund të punojnë, të punësohen ose të vetëpunësohen nën të njëjtat kushte si shtetasit sillovenë. Kjo vlen për qasjen në konkurseve të vendeve të punës, kushtet e punës dhe përfitimet sociale dhe fiskale. Kontributet e sigurimeve shoqërore (sigurimi pensional dhe invalidor, sigurimi i papunësisë) të paguara nga shtetas të BE/ZEE dhe shtetasve zviceranë gjithashtu mund të transferohen në vendin e banimit. Kjo do të thotë se gjatë kryerjes së punës dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore në Siloveni kjo periudhë konsiderohet të jetë një periudhë e përbashkët e punësimit në vendin ku banoni.

---

## **KUSH**

Qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së ose ZEE-së dhe shtetasve zviceranë.

---

## **SI**

Në Siloveni ju mund të gjeni punë në portalet online, siç është EURES që ofron vende pune në Evropë. Ju gjithashtu mund të kontaktoni Këshilltarin EURES në vendin tuaj, i cili do t'ju këshilloj para se të filloni një kërkim pune, gjatë punës dhe pas kthimit në shtëpi. Konkursat për punë në EURES klasifikohen sipas kategorive të ndryshme (zona e punës, vendi, etj.). Ju gjithashtu mund të shkarkoni CV-në tuaj në portalin EURES, i cili më pas është i disponueshëm për punëdhënësit në Evropë.

---

## **MIRË ËSHTË TA DINI**

Punëtorët me profesione të rregulluara, siç infermieret e mjekësisë së përgjithshme, farmacistët, fizioterapeutët, agjentët e pasurive të paluajtshme dhe udhëzuesit e malit, shkaku i Kartës Profesionale Evropiane (European Professional Card – EPC) mund të kryejnë profesionet e tyre në Shtetet Anëtare të BE-së me kufizime më të vogla kualifikimesh profesionale. Karta Profesionale Evropiane është një çertifikatë që synon lehtësimin e lëvizshmërisë së këtyre profesioneve nëpërmjet një procedure të thjeshtuar për njohjen e kualifikimeve profesionale në Siloveni. Më shumë informacion mund të gjeni këtu (në anglisht):

<http://europa.eu/youreurope/citizens/work/professional-qualifications/professional->



[bodies-language-requirements/index\\_en.htm](https://bodies-language-requirements/index_en.htm)

## Punësimi i shtetasve të vendeve të treta

### LLOJET E LEJEVE TË QËNDRIMIT DHE LEJEVE TË PUNËS

#### ÇFARË

Një leje pune në Slloveni lidhet drejtpërdrejt me një leje qëndrimi.

Për të filluar të jetoni dhe të punoni në Slloveni, duhet të aplikoni për një nga lejet e mëposhtme:

- Leje e njëtrajtshme qëndrimi dhe pune,
- Karta Blu e BE-së,
- Leje pune për shtetasit e BiH.

Për të marrë leje të njëtrajtshme qëndrimi dhe pune ose kartë blu të BE-së, duhet të aplikoni në misionin diplomatik të Republikës së Sllovenisë para se të hyni në Slloveni. Megjithatë, punëdhënësi mundet, në bazë të autorizimit të të huajit, të paraqesë një kërkesë në njësinë administrative.

Në rastin e punësimit të shtetasve të BiH, punëdhënësi juaj duhet të aplikojë për një leje pune në Slloveni dhe të paguajë shpenzimet e procedurës. Aplikimi dorëzohet në Entin për Punësim të RS-së.

Në disa raste do ju nevojitet një leje pune e veçantë (leje pune për punëtorët sezonalë në rast të një kontrate të lidhur).

Ju keni qasje të lirë në tregun e punës në Slloveni nëse:

- jeni mbajtësi i një leje qëndrimi të përhershëm,
- jeni mbajtës i lejes së qëndrimit të përkohshëm, por njëkohësisht jeni një i huaj me origjinë sllovene, një anëtar i familjes së shtetasve sllovenë, viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore ose viktimë të punës ilegale,
- keni dorëzuar kërkesën për vazhdimin e lejes së qëndrimit tuaj.

Qasje e lirë në tregun e punës është gjithashtu e mundur për:



- personat me mbrojtje ndërkombëtare (statusin e refugjatit ose mbrojtjen subsidiare) dhe anëtarët e familjes së tyre (bashkimi familjar),
- personat me mbrojtje të përkohshme,
- aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare (nëntë muaj pas dorëzimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare).

Qasja e lirë në tregun e punës do të thotë që ju mund të punësoheni dhe punoni nën të njëjtat kushte si shtetasit slloven dhe punëdhënësi juaj nuk ka nevojë për leje pune të posaçme.

Për më shumë informacion mbi lejet e qëndrimit, shih Kapitullin 1. “Arritja dhe Qëndrimi”.

## Çfarë duhet të bëni në rast të lëndimit

---

### ÇFARË

---

### MIRË ËSHTË TA DINI

---

### HAPI

HAPI 1: Nëse një lëndim ndodh në punë, duhet ta lajmëroni atë pranë Inspektoratit të Punës të RS-së. Në rast aksidenti, punëdhënësi menjëherë duhet të plotësoj të ashtuquajturin formularin ER-8 në katër kopje. Të gjitha kopjet duhet të nënshkruhen nga personi i dëmtuar, dëshmitari dhe punëdhënësi.

Më shumë për këtë mund të lexoni në faqen e internetit të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (në sllovenisht): <http://www.nijz.si/sl/podatki/prijava-poskodbe-pri-delu>





HAPI 2: Nëse është e mundur, merrni kopjet e formularit ER-8 me vete tek mjeku ose në spital, ose kërkoni që dikush ti sjellë ato.

HAPI 3: Mjeku juaj e plotëson formularin ER-8 me informacionin tuaj shëndetësor dhe ia dërgon atë punëdhënësit tuaj dhe shërbimeve të tjera përkatëse.

HAPI 4: Nëse e keni raportuar lëndimin në përputhje me procedurën e përshkruar, ju mund të kërkoni rimbursimin e sigurimi shëndetësor. Nëse nuk e raportoni lëndimin, nuk mund të kërkoni rimbursimin e sigurimit.

---

## ÇFARË DUHET TË BËNI NË RAST TË LËNDIMIT

### ÇFARË

Nëse jeni lënduar në punë ose në rrugë për në ose nga puna, kontaktoni mjekun tuaj, spitalin më të afërt ose telefononi numrin e emergjencës 112. Nëse lëndimi është shumë i rënd, menjëherë kontaktoni mjekun ose shkoni në spital. Tek mjeku ju duhet karta e sigurimi shëndetësor – sigurohuni që gjithmonë ta keni atë me vete.

### KU

Lista e spitaleve në Slloveni. Për lëndime të lehta mund të shkoni në një qendër shëndetësore.

<http://www.abczdravja.si/index.php/bolnisnice-v-sloveniji>

Lista e qendrave shëndetësore në Slloveni:

: <http://www.abczdravja.si/index.php/zdravstveni-domovi-v-sloveniji>

Informacioni mbi procedurën për punëdhënësin, në rast të lëndimit në punë, është në dispozicion në institutin e mëposhtëm:

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

Trubarjeva 2

1000 Ljubljana

Tel.: +386 1 2441 400

<http://www.nijz.si>



Email: [info@nijz.si](mailto:info@nijz.si)

## DËMSHPËRBLIMI NË PARA

### ÇFARË

Nëse jeni i përfshirë në politikën e sigurimit të detyrueshëm të pensionit dhe invaliditetit, ju mund të kërkonti të drejta të ndryshme në rast të lëndimit në punë, rezultati i të cilit është përfitime në para.

- Pensioni invalidor, nëse aftësia juaj e kufizuar është aq e rëndë sa që nuk jeni më në gjendje të punoni,
- Ndihmë për invaliditet nëse keni statusin e invalidit,
- Invaliditet nëse keni një paftësi fizike.

Më shumë informacion rreth dëmshpërblimit në para lexoni këtu:

Instituti për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të

Sllovenisë: <https://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=25>

### KU

Për më shumë informacion mbi përfitimet në para në rast të lëndimit në punë, mund të kontaktoni institucionet e mëposhtme:

Instituti për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Sllovenisë

[https://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=25\\_](https://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=25_)

Instituti për Sigurimin Pensional dhe Invalidor – ZPIZ

<https://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=25>

Kolodvorska ulica 15

1000 Ljubljana

Tel.: +386 1 474 51 00

<https://www.zpiz.si/cms/?ids=zpizen>

E-naslov: [informacije@zpiz.si](mailto:informacije@zpiz.si)

Qendra për punë sociale (Centre of social work)

Listën e qendrave për punë sociale e gjeni



---

këtu: <https://www.scsd.si/seznam-centrov-za-socialno-delo.html>\_



# Dëmshpërblimi dhe ndihma për aksidentet dhe lëndimet në punë

## DËMSPËRBLIMI PËR LËNDIME NË PUNË

### ÇFARË

Në rast aksidenti në punë, ju keni të drejtë për dëmshpërblim financiar. Dëmtimi në punë do të thotë që ju jeni lënduar gjatë procesit të punës, në rrugën drejt ose nga puna, nëse transporti është organizuar nga punëdhënësi ose kur jeni në një udhëtim pune. Ju mund të kërkonit kompensim nëse aksidenti nuk ka ndodhur për shkak të neglizhencës tuaj. Dëmshpërblimi jepet vetëm nëse është bërë regjistrimi i dëmtimit tuaj.

Dëmshpërblimi paguhet nga shoqëria e sigurimit nëse punëdhënësi juaj ka lidhur sigurimin në rast të lëndimit në punë dhe sigurimit kolektiv të aksidenteve, dhe nëse i ka paraqitur të gjitha masat e nevojshme të sigurisë në punë. Nëse punëdhënësi juaj nuk ka bërë sigurim, ju nuk mund të bëni padi kundër tij. Për të kërkuar dëmshpërblim, ju nevojiten dokumentet e mëposhtme: Formulari ER-8 (Raporti i lëndimit në punë), procesverbali i shkruara i aksidentit, kopjet e dokumenteve mjekësore ose certifikatën shëndetësore, deklaratat e dëshmitarëve, certifikatën mjekësore e mjekut tuaj, raportin tuaj të aksidentit dhe faturat.

### KU

Dëmshpërblimin e kërkonit nga kompani private e sigurimeve ku punëdhënësi juaj ka lidhur një marrëveshje sigurimi për raste dëmtimi në punë.

Rreth lëndimeve në punë mësoni më shumë këtu:

<http://www.visokaodskodninaplaninsec.si/nezgoda-na-delovnem-mestu>

## KOMPENSIMI I PAGËS GJATË MUNGESËS SË PËRKOHSHME NGA PUNA - SIGURIMI SHËNDETËSOR

### ÇFARË

Nëse ju sëmuheni, punëdhënësi ju paguan kompensimin e pagës nga asetet e



kompanisë tuaj për 30 ditët e para gjatë një mungese të përkohshme nga puna. Ju duhet t'i paraqisni punëdhënësit certifikatën e pushimit mjekësor të lëshuar nga mjeku juaj.

Nëse mungesa juaj është më e gjatë se 30 ditë, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor do t'ju paguajë pagën pas marrjes së mendimit të një mjeku ose një komisioni të përshtatshëm shëndetësor të Institutit të Kujdesit Shëndetësor.

Shuma e kompensimit të pagave varet nga paga mesatare mujore e personit të siguruar dhe nga ndihmat në vitin para vitit në të cilin ndodh mungesa e përkohshme nga puna.

Më shumë informacion në lidhje me rimbursimin është në dispozicion në faqen e internetit në vijim

[https://zavarovanec.zzzs.si/wps/portal/portali/azos/nadomestila/nadom\\_place/nadom\\_visina/](https://zavarovanec.zzzs.si/wps/portal/portali/azos/nadomestila/nadom_place/nadom_visina/)

## KU

Organi kompetent është Instituti i Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë.

Instituti i Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë – lista e personave kontaktues (në sllovenisht): <http://www.zzzs.si/imenik>

---

## REHABILITIMI PAS LËNDIMIT NË PUNË

### ÇFARË

Në rast të lëndimeve të rënda në punë që rezultojnë me paaftësi të përhershme për punë, ju keni të drejtë për mbështetje të ndryshme mjekësore dhe profesionale. Çfarë lloj mbështetjeje do të merrni varet nga shkalla e lëndimit dhe nëse jeni përfshirë në sigurimin pensional dhe invalidor. Ju mund të ushtroni të drejtat e mëposhtme:

- Të drejtat që ju kërkoni në bazë të sigurimit të detyrueshëm të pensionit dhe invaliditetit në Institutin për sigurim pensional dhe invalidor
- Të drejtat që ju kërkoni në bazë të regjistrimit në regjistrin e të papunëve në Entin e Republikës së Sllovenisë për Punësim

Lexoni më shumë në kapitullin 5.4.2.a “Të Drejtat dhe Punësimi”.



## KU

Për më shumë informacion mbi shëndetin dhe rehabilitimin profesional në rast të lëndimeve në punë, kontaktoni Institutin e Sigurimeve të Pensionit dhe Invaliditetit të Sllovenisë dhe Entin e Republikës së Sllovenisë për Punësim

Instituti i Sigurimeve Shëndetësore të  
Sllovenisë <https://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=25>

Instituti i Sigurimeve të Pensionit dhe Invaliditetit të Sllovenisë – ZPIZ  
Kolodvorska ulica 15  
1000 Ljubljana  
Tel.: +386 1 474 51 00  
<https://www.zpiz.si/cms/?ids=zpizen>  
Email: [informacije@zpiz.si](mailto:informacije@zpiz.si)

Enti i Republikës së Sllovenisë për Punësim – lista e kontakteve dhe  
adresave: <https://www.ess.gov.si/kontakt>

## **Ndihmë sociale e jashtëzakonshme financiare për të ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve funerale – varrimin**

---

### **ÇFARË**

Kjo ndihmë financiare u paguhet anëtarëve të familjes së të ndjerit, të cilët nuk mund të përballojnë pagesën e funeralit.

Më shumë informacion mund të gjeni në:

<https://e-uprava.gov.si/podrocja/sociala-zdravje-smrt/smrt/pogrebnina-posmrtnina.html>

[http://www.mddsz.gov.si/si/delovna\\_podrocja/sociala/pogrebnina\\_in\\_posmrtnina/](http://www.mddsz.gov.si/si/delovna_podrocja/sociala/pogrebnina_in_posmrtnina/)



---

## KUSH

Këtë të drejtë mund ta merrni nëse:

- jeni shtetas i Sllovenisë,
- jeni mbajtësi i një leje qëndrimi të përhershëm me adresë të përhershme të regjistruar në Slloveni,
- jeni një anëtar i familjes të personit të vdekur (një bashkëshort ose person me të cilin ai ose ajo kishte jetuar në një bashkësi të pamartuar ose partneritet të regjistruar të gjinisë së njëjtë, fëmijët dhe fëmijët nën kujdestari, prindërit ose një person me të cilin njëri nga prindërit jeton në një martesë ose në një bashkësi të pamartuar ose në një partneritetet e të njëjtes gjini,
- varrimi është i organizuar në Slloveni
- në ditën e vdekjes së personit të vdekur, keni të drejtë tek ndihma sociale financiare,

## OSE

- Të ardhurat tuaja ose të ardhurat totale të familjes suaj nuk e tejkalojnë cenzusin e caktuar ligjor.

---

## SI

Kur organizoni një funeral, kërkoni shërbimin e varrimit për t'ju dhënë një vlerësim paraprak të kostos. Kur paguani shërbimin e varrimit, ruajeni faturën. Brenda një viti pas vdekjes së të ndjerit, mund të aplikoni në qendrën për punë sociale, aplikacionit i bashkëngjitni certifikatën e vdekjes dhe faturën ose vlerësimin paraprak të kostos së funeralit.

Nëse keni nevojë dhe nuk mund ta paguani funeralin, shërbimi i varrimit do t'ju dërgojë në qendrën për punë sociale ku mund të paraqisni kërkesën menjëherë. Qendra gjithashtu menjëherë do të nxjerrë një vendim në mënyrë që të mbuloni koston e funeralit.

---



---

## KUR

Brenda një viti nga vdekja e personit të vdekur.

---

## KU

Rekomandohet që të aplikoni në të njëjtën Qendër për Punë Sociale, ku keni aplikuar edhe për ndihmë sociale financiare.

Lista e qendrave për punë

sociale <https://www.scsd.si/seznam-centrov-za-socialno-delo.html>

Ministria e Punës, Familjes, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Kotnikova 28

1000 Ljubljana

Slovenija

Tel.: +386 1 369 77 00

<http://www.mddsz.gov.si>

Email: [gp.mddsz@gov.si](mailto:gp.mddsz@gov.si)





---

## Ndihmë e jashtëzakonshme financiare për vdekjen e një anëtar i të familjes.

---

### ÇFARË

E drejta për një ndihmë të jashtëzakonshme financiare (pas vdekjes) mund të zbatohet nga të afërmit e personit të vdekur, nëse ata kanë të drejtë të marrin ndihmë sociale financiare, nën kusht që të ardhurat e tyre nuk e kalojnë cenzusin ligjor.

Më shumë informacion mund të gjeni në:

<https://e-uprava.gov.si/podrocja/sociala-zdravje-smrt/smrt/pogrebnina-posmrtnina.html>

[http://www.mddsz.gov.si/si/delovna\\_podrocja/sociala/pogrebnina\\_in\\_posmrtnina/](http://www.mddsz.gov.si/si/delovna_podrocja/sociala/pogrebnina_in_posmrtnina/)

---

### KUSH

Këtë të drejtë mund ta merrni nëse:

- jeni shtetas i Sllovenisë,
- jeni mbajtësi i një leje qëndrimi të përhershëm me adresë të përhershme të regjistruar në Slloveni,
- jeni një anëtar i familjes të personit të vdekur (një bashkëshort ose person me të cilin ai ose ajo kishte jetuar në një bashkësi të pamartuar ose partneritet të regjistruar të gjinisë së njëjtë, fëmijët dhe fëmijët nën kujdestari, prindërit ose një person me të cilin njëri nga prindërit jeton në një martesë ose në një bashkësi të pamartuar ose në një partneritetet e të njëjtes gjini,
- në ditën e vdekjes së personit të vdekur, keni të drejtë tek ndihma sociale financiare,  
OSE



---

Të ardhurat tuaja ose të ardhurat totale të familjes suaj nuk e tejkalojnë cenzusin e caktuar ligjor.

---

## **SI**

Këtë të drejtë mund ta kërkonti pranë Qendrës për Punës Sociale ku dorëzoni një aplikacion, të cilit i bashkëngjitni certifikatën e vdekjes nëse ky informacion ende nuk është në regjistër.

---

## **KUR**

Brenda një viti nga vdekja e personit të vdekur.

---

## **MIRË ËSHTË TA DINI**

Kjo ndihmë i jepet vetëm një personi që ka aplikuar, që do të thotë se përfituesi mund të jetë vetëm një person nga familja.

---

## **KU**

Ju mund të aplikoni përnjë cilës do qendër pëe punës sociale – lista e qendrave për punë sociale

<https://www.scsd.si/seznam-centrov-za-socialno-delo.html>

Ministria e Punës, Familjes, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Kotnikova 28 1000 Ljubljana

Slovenija

Tel.: +386 1 369 77 00

<http://www.mddsz.gov.si>

Email: [gp.mddsz@gov.si](mailto:gp.mddsz@gov.si)



---

## Pensionet për refugjatët

---

### ÇFARË

Nuk ka pensione për refugjatët në Slloveni. Refugjatët mund të marrin një pension në qoftë se ata kanë një numër minimal të viteve të sigurimit të paguar, siç kërkohet me ligj.



---

# Pensioni i parakohshëm

---

## ÇFARË

Pensioni i parakohshëm është një përfitim në të holla që ju takon,

- nëse jeni person i përfshirë në sigurimin e invaliditetit dhe të pensionit,
- keni përmbushë një moshë të caktuar të pensionit dhe të pleqërisë,
- nuk keni të drejtë të pensionit.

Kushtet për marrjen e të drejtës për pension të parakohshëm janë të ndryshme sipas gjinisë.

Më shumë rreth daljes në pension të parakohshëm mund të lexoni këtu (në sllovenisht): <https://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=327>

---

## KU

Ju mund të dorëzoni një aplikacion në portalin e internetit ZPIZ (vetëm nëse keni certifikatë dixhitale) ose me postë apo personalisht në Institutin e Sigurimeve të Pensionit dhe Invaliditetit të Sllovenisë.

<http://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=312>

Instituti për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Sllovenisë (ZPIZ):

<https://www.zpiz.si>



---

## Sigurimi shtesë i pensioneve

---

### ÇFARË

Nëse dëshironi të siguronit një burim shtesë të ardhurash kur jeni në pension, mund të paguani një sigurim shtesë pensional. Sigurimi i tillë është një lloj kursimi në llogarinë tuaj personale të një anëtari të fondit pensional, i cili menaxhohet nga menaxhmenti i fondit të pensionit.

---

### KUSH

Çdo punonjës që paguan kontribute për sigurimin e detyrueshëm të pensionit dhe që dëshiron të marrë një pension shtesë.

---

### KUR

Ju vetë mund të vendosni për veten tuaj nëse doni të filloni të paguani sigurim shtesë pensionesh dhe kur.

---

### MIRË ËSHTË TA DINI

Kontributet për sigurimin shtesë të pensioneve mund të filloni ose të ndaloni të paguani në çdo kohë gjatë jetës suaj të punës.

---

### KU

Sigurimi pensional shtesë në Slloveni janë fonde private:

- Banka Intesa Sanpaolo, d. d. (OVPS Banke Koper) (në anglisht)



<http://www.intesasanpaolobank.si/>

- Generali Zavarovalnica, d. d. (në sllovenisht)  
<https://www.generali.si/fizicne-osebe/>
- Modra zavarovalnica (në anglisht) <http://www.modra-zavarovalnica.si/home/>
- Pokojninska družba A (në sllovenisht)  
<http://www.modra-zavarovalnica.si/home/>
- Skupna pokojninska družba, d. d. (në sllovenisht)  
<https://www.skupna.si/default.aspx>
- Sava, pokojninska družba, d. d. (në sllovenisht)  
<https://www.sava-pokojninska.si/>
- Prva osebna zavarovalnica, d. d. (në sllovenisht) <http://www.prva.net/>
- Zavarovalnica Triglav, d. d. (në sllovenisht) <https://www.triglav.si/>
- Adriatic Slovenica, zavarovalna družba, d. d. (në anglisht)  
<https://www.as-skupina.si/en/home>

## KUJDES

Në përgjithësi vlen që nëse para periudhës së dakorduar, dëshironi të nxjerrni një shumë paushalle të plotë nga ky sigurim, duhet të paguani një kompensim financiar.



---

## Pensioni i pleqërisë

---

### ЧТО

Një pension i pleqërisë është e drejta për të marrë të ardhura të rregullta mujore kur arrini një moshë të caktuar. Pensioni i pleqërisë ju takon nëse keni paguar sigurimin e pensionit dhe invaliditetit për një numër vitesh të caktuar dhe kur arrini moshën e caktuar. Përveç kësaj, ju duhet të plotësoni edhe disa kushte të tjera. Më shumë rreth kushteve për pension të pleqërisë mund të gjeni në faqen e internetit të Institutit për Sigurimin e Invaliditetit dhe Pensioneve të Sllovenisë: (në sllovenisht): <http://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=326> (në anglisht): <http://www.zpiz.si/cms/contenten/old-age-pension>

---

### KUSH

Kushtet për marrjen e të drejtës për pension të pleqërisë ndryshojnë gjatë një periudhe kalimtare sipas gjinisë.

Në vitin 2018, gratë kanë të drejtën e pensionit të pleqërisë kur plotësojnë:

- 59 vjeç dhe 8 muaj pleqëri dhe kanë 40 vjet të periudhës së pensionit pa blerje
- 64 vjet dhe kanë së paku 20 vjet periudhën e pensionit
- 65 vjet dhe kanë të paktën 15 vjet sigurim

Burrat kanë të drejtën e pensionit të pleqërisë kur plotësojnë:

- 60 vjeç dhe kanë 40 vjet të periudhës së pensionit pa blerje
  - 65 vjeç dhe të paktën 15 vjet sigurim.
- 

### MIRË ËSHTË TA DINI

Periudha e pensionimit pa blerje është në parim një periudhë,



- kur ju jeni përfshirë në sigurimin e detyrueshëm të pensionit dhe të invaliditetit (keni paguar sigurimin e detyrueshëm të pensionit dhe invaliditetit)
- kur jeni përfshirë vullnetarisht në sigurimin e detyrueshëm deri më 31.12.2012
- kur jeni angazhuar në bujqësi
- Jeni punësuar jashtë vendit dhe keni paguar sigurim atje.

Ju gjithashtu mund të blini periudhën e pensionit, por tek pensioni i pleqërisë kjo nuk llogaritet.

Periudha e pensionit përfshin sigurimet dhe periudhen e veçantë, sipas të cilave përcaktohen kushtet për marrjen e të drejtës për pension dhe sipas së cilës përcaktohet përqindja për vlerësimin e pensionit (shuma e pensionit).

Periudha e sigurimit është periudha kur personi ka qenë i përfshirë qoftë në sigurim të detyrueshëm apo atë vullnetar dhe periudhat për të cilat janë paguar kontributet.

---

## KU

Kërkesa për njohjen e të drejtës për pension (Formulari i aplikimit është në dispozicion në faqen e internetit të Institutit) duhet paraqitur në njësinë rajonale të Institutit të Sigurimeve të Pensionit dhe Invaliditetit të Sllovenisë ku mund të merrni më shumë informacione.

Instituti për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Sllovenisë – ZPIZ

Kolodvorska ulica 15

1000 Ljubljana

Tel.: +386 1 474 51 00

(në sllovenisht) <http://www.zpiz.si/cms/?ids=zpizen>

Email: [informacije@zpiz.si](mailto:informacije@zpiz.si)

Degët rajonale të Institutit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Sllovenisë

(në sllovenisht): <http://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=412>

(në anglisht): <https://www.zpiz.si/cms/?ids=contenten&inf=510>

---





## KUJDES

Kushtet për marrjen e të drejtës për pension në moshën minimale (60 vjeç), do të barazohen në vitin 2019 për të dyja gjinitë dhe gjithashtu të gjitha opsionet tjera për marrjen e të drejtës për pension të pleqërisë do të barazohen më 1 janar 2020.



---

# Përfshirja vullnetare në sigurimin e detyrueshëm

---

## KUSH

Nëse keni vendbanim në Slloveni dhe jeni mbi 15 vjeç, por nuk i plotësoni kushtet për përfshirje në sigurimin e detyrueshëm të pensionit dhe invaliditetit, ju mund të angazhoheni në sigurime në baza vullnetare. Përveç kësaj, ju duhet të plotësoni edhe kushtet e mëposhtme:

- nuk jeni i punësuar me orarë të plotë pune,
- nuk jeni i vetëpunësuar
- nuk ekziston asnjë bazë tjetër nën të cilën mund të sigurohenin detyrimisht.

Një person i cili është i punësuar me orarë të shkurtër nga orari i plotë mund të përfshihet në sigurimin vullnetar të detyrueshëm për diferencën e orarit të plotë.

Në sigurimin vullnetar të detyrueshëm mund të përfshihet personi, i cili është i angazhuar në një aktivitet bujqësor dhe nuk përmbush kushtin nga aktiviteti bujqësor për nivelin e të ardhurave për përfshirje në sigurimin e detyrueshëm.

Më shumë rreth përfshirjes vullnetare në sigurimin e detyrueshëm mund të lexoni këtu (në sllovenisht):

<https://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=86>

---

## KU

Kërkesa për përfshirje vullnetare në sigurimin e detyrueshëm të pensionit dhe invaliditetit mund të dorëzohet pranë pranë shërbimin të regjistrimit dhe çregjistrimit tek Institutit i Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë.

Instituti i Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë  
Miklošičeva cesta 24



---

1507 Ljubljana

T: +386 1/30 77 296

(në sllovenisht): <http://www.zzzs.si/>

(në anglisht): <http://www.zzzs.si/indexeng.html>

Degët rajonale të Institutit të Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë

(në sllovenisht): <http://www.zzzs.si/imenik>

(në

anglisht): <http://www.zzzs.si/zzzs/internet/zzzseng.nsf/o/8367C5ACCE9DCB61C12>

5756F00349F00



---

## Pension familjar

---

### ÇFARË

Pensioni familjar është një përfitim në të holla që i përket anëtarëve të familjes të të ndjerit që ka gëzuar pensionin ose të të siguruarit të ndjerë që ka plotësuar periudhën pensionimi të caktuar. Megjithatë, duhet të plotësohen edhe disa kushte të tjera ligjore.

Për më shumë informacion, ju lutemi lexoni në faqen e internetit të Institutit të Sigurimeve të Pensionit dhe Invaliditetit në:

<https://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=329> ose kontaktoni Institutin për Sigurimin e Pensionit dhe Invaliditetit.

---

### KUSH

Të drejtën për pensionin familjar mund ta zbatojnë:

- fëmijët, fëmijët e vegjël, nipërit e mbesat dhe fëmijët e tjerë pa prindër të kujdesur nga i siguruari, ose
- prindërit të cilët kanë qenë nën kujdesin e personit të siguar në pajtim me rregulloret ligjore

E drejta për një pension familjar pranohet nëse plotësohen kushtet në anën e të ndjerit dhe në anën e anëtarëve të familjes. Kushtet që duhet të plotësohen në anën e të ndjerit:

- i ka plotësuar kushtet për marrjen e të drejtës për pension të hershëm, pleqërie ose invaliditeti, ku vdekja konsiderohet si invaliditeti i kategorisë I
- ka qenë përfituesi i pensionit të hershëm, pleqërie ose invaliditeti ose përfitues i përfitimeve të invaliditetit nga sigurimi i detyrueshëm;



---

Kushtet që duhet të plotësohen nga anëtarët e familjes:

Fëmijët kanë të drejtë për pension familjar deri në moshën 15 vjeç ose deri në fund të shkollimit, por më së shumti deri në moshën 26 vjeçare.

Prindërit kanë të drejtën e pensionit familjar nëse:

- deri në kohën e vdekjes së të ndjerit ata kanë mbushur moshën 60 vjeç ose
- në kohën e vdekjes së të ndjerit ishin plotësisht të paaftë për punë.

---

## **KUR**

Në çdo kohë pas vdekjes së bashkëshortit. Nëse paraqitni kërkesën më vonë se gjashtë muaj pas vdekjes së bashkëshortit, pensioni do të ju paguhet nga dita e parë e muajit pas paraqitjes së kërkesës dhe jo më shumë se gjashtë muajt e kaluar.

---

## **MIRË ËSHTË TA DINI**

Në disa raste, për të drejtën e pensionit familjar duhet të plotësohen edhe disa kushte shtesë, dmth. që personi i vdekur deri në vdekjen e tij është kujdesur për një anëtar të familjes dhe se anëtari i familjes së bashku me të ndjerin kanë pasur një qëndrim të përhershëm të përbashkët deri në vdekjen e tij.

---

## **KU**

Kërkesa për njohjen e së drejtës për pension të vejushës/vejanit i dërgohet Institutit të Sigurimeve të Pensionit dhe Invaliditetit të Sllovenisë.

Instituti për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Sllovenisë  
Kolodvorska ulica 15

1000 Ljubljana



---

Tel.: +386 1 474 51 00

(në sllovenisht): <https://www.zpiz.si/cms/?ids=zpizen>

Email: [informacije@zpiz.si](mailto:informacije@zpiz.si)

Degët rajonale të Institutit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Sllovenisë

(në sllovenisht): <http://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=412>

(në anglisht): <https://www.zpiz.si/cms/?ids=contenten&inf=510>



## Pensioni i ve/jë-së

---

### ÇFARË

Pensioni i vejushës/vejanit është një e drejtë që mund të zbatoni pas vdekjes së bashkëshortit ose partnerit nëse partneri i vdekur ka mbushur moshën 56 vjeç dhe ka qenë me i siguruar për pension dhe invaliditet ose ka gëzuar të drejtat e këtij sigurimi. Gjithashtu, duhet të plotësohen edhe disa kushte të tjera.

Më shumë për të drejtën e pensionit të vejushës/vejanit mund të lexoni në faqen e internetit të Institutit të Sigurimeve të Pensionit dhe Invaliditetit të Sllovenisë:

(në sllovenisht): <https://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=330>

(në anglisht): <https://www.zpiz.si/cms/?id=11&inf=502>

---

### SI

Për të pasur të drejtën e pensionit të ve/jë-së, duhet të plotësohen kushtet në anën e vejushës/vejanit si dhe të të ndjerit.

Kushtet në anën e vejushës/vejanit:

- deri tek vdekja e partnerit tuaj keni qenë plotësisht i paaftë për punë ose jeni bërë një vit pas vdekjes së partnerit tuaj;
- Pas vdekjes së partnerit tuaj, keni një ose më shumë fëmijë që kanë të drejtën e pensionit familjar, dhe ju jeni të detyruar t'i mbijetoni ata.

Kushtet në anën e të ndjerit:

- i ka plotësuar kushtet për marrjen e të drejtës së pensionit të hershëm, të pleqërisë ose invaliditetit, ku vdekja konsiderohet si invaliditet i kategorisë I.
- ka marrë një pension të hershëm, pleqërie ose invaliditeti ose ishte përfitues i përfitimeve të invaliditetit nga sigurimi i detyrueshëm;

Përveç vejushës ose vejanit, të drejtën për pension mund të ushtroni gjithashtu



---

nëse

- I pandjeri është bashkëshorti juaj i divorcuar (nëse ai kishte të drejtën e alimentacionit dhe po e gëzonte atë deri në vdekjen e ish bashkëshortit/es)
- nëse bashkëshorti është nga një martesë e mëvonshme,
- personi, i cili në tre vitet e fundit para vdekjes së një personi të siguruar ose përfitues të të drejtave ka jetuar në një bashkim familjar që është i barabartë në pasojat juridike me martesën ose
- ka jetuar me të në një bashkim të tillë familjar për vitin e fundit para vdekjes dhe ka pasur ndonjëherë, në çdo kohë, një fëmijë me të;
- partneri që jetonte me të ndjerin në lidhje partneriteti.

Një e ve gjithashtu mund të ketë të drejtën e pensionit të vejës nëse ajo lind një fëmijë të personit të siguruar brenda 300 ditësh nga vdekja e tij.

---

## **KUR**

Në çdo kohë pas vdekjes së bashkëshortit. Nëse paraqitni kërkesën më vonë se gjashtë muaj pas vdekjes së bashkëshortit, pensioni do të ju paguhet nga dita e parë e muajit pas paraqitjes së kërkesës dhe jo më shumë se gjashtë muajt e kaluar.

---

## **KU**

Kërkesa për njohjen e së drejtës për pension të vejushës/vejanit i dërgohet Institutit të Sigurimeve të Pensionit dhe Invaliditetit të Sllovenisë.

Instituti për Sigurimin PENSIONAL dhe INVALIDOR të Sllovenisë  
Kolodvorska ulica 15  
1000 Ljubljana





Tel.: +386 1 474 51 00

(në sllovenisht): <https://www.zpiz.si/cms/?ids=zpizen>

Email: [informacije@zpiz.si](mailto:informacije@zpiz.si)

Degët rajonale të Institutit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Sllovenisë

(në sllovenisht): <http://www.zpiz.si/cms/?ids=content&inf=412>

(në anglisht): <https://www.zpiz.si/cms/?ids=contenten&inf=510>

## Masat e politikës aktive të punësimit

### ÇFARË

Enti i RS-së për Punësim ka zhvilluar një sërë masash që mund t'ju ndihmojnë të përforconi aftësitë dhe njohuritë tuaja për t'ju ndihmuar të merrni një punë më të mirë në tregun e punës dhe që ju ndihmojnë të gjeni një punë.

Masat zbatohen në kuadër të tre programeve të ndryshme:

- Trajnimi dhe arsimimi: me këto programe mund të fitoni edukim, njohuri dhe aftësi për të kryer lloje të caktuara pune ose profesionesh. Ju gjithashtu mund të merrni përvojë nga puna praktike, e cila do ju sigurojë një gjendje më të mirë gjatë kërkimit të punës.
- Punësimi: këto programe u ofrojnë punëdhënësve subvencione në para për të promovuar punësimin e të papunëve. Këto programe ju ndihmojnë të gjeni punësim me orar të plotë, i cili siguron siguri më të mirë sociale. Ju keni mundësinë për t'u integruar në mjedisin e punës, për të fituar njohuri të reja dhe për të përmirësuar mundësitë tuaja të punës. Punëdhënësi merr ndihmë financiare ose është i liruar nga taksat e caktuara.
- Vetëpunësimi: nëse keni një ide interesante të biznesit dhe dëshironi të filloni biznesin tuaj, ju mund të merrni një subvencion nga Enti i Punësimit të Sllovenisë për kompaninë tuaj fillestare. Kontrolloni në Entin e Punësimit të Sllovenisë se cilat janë grupet e synuara që mund të aplikojnë për ndonjë nga programet e mësipërme.

Më shumë informacion mbi masat aktive të politikave të punësimit mund të gjenden në lidhjen e mëposhtme:



---

[https://www.ess.gov.si/iskalci\\_zaposlitve/programi](https://www.ess.gov.si/iskalci_zaposlitve/programi)

---

## **KUSH**

Ju mund të merrni pjesë në këto programe nëse jeni regjistruar si person i papunësuar pranë ERSP. Ju gjithashtu duhet të plotësoni kriteret për përfshirje në një program të caktuar: mosha, kohëzgjatja e papunësisë, arsimit, etj. Preferohen personat e papunë që ende nuk janë përfshirë në ndonjë program aktiv të politikës së punësimit.

---

## **KU**

Shërbimi i Punësimit:

<https://www.ess.gov.si/kontakt>

## **KUJDES**

Programet e politikave aktive të punësimit janë hartuar si projekte për një periudhë të caktuar kohore – domethënë ato vazhdimisht ndryshojnë. Për informacione më të rëndësishme lidhur me programet aktualisht në dispozicion, kontaktoni ERSP.



---

## Format e tjera të mbështetjes së papunësisë

---

### KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE TË UDHËTIMIT

#### ÇFARË

E drejta për kompensim për shpenzimet e udhëtimit që rrjedhin nga një udhëtim në një intervistë pune është një nga të drejtat për të cilat ju keni të drejtë si person i papunë kur jeni regjistruar në Entin e Punësimit të Sllovenisë. Për të rimbursuar ju duhet të dorëzoni një kërkesë në Entin e Punësimit të Sllovenisë së bashku me vulën dhe nënshkrimin e punëdhënësit për të dëshmuar praninë tuaj në intervistë. Shuma e rimbursimit varet nga distanca e vendbanimit tuaj me vendin e intervistës.

#### KU

Enti i Punësimit:

<https://www.ess.gov.si/kontakt>

---

### SIGURIMI I DETYRUESHËM SHËNDETËSOR

#### ÇFARË

Nëse jeni të papunë, por nuk merrni kompensim dhe nuk keni ndonjë burim tjetër të të ardhurave as ndonjë person në gjendje t'ju paguajë sigurimin shëndetësor të detyrueshëm (p.sh. partneri juaj ligjor), ju mund të kërkonit të drejtën për sigurim shëndetësor bazë për veten dhe anëtarët e familjes tuaj. Aplikimi dorëzohet në zyrën komunale ku jetoni.

#### KU

Ju mund të aplikoni në komunën ku banoni.

Lista e komunave <https://skupnostobcin.si/podatki/zemljevid-obcin-tabela/#p2>



## FONDI GARANTUES

### ÇFARË

Kur ngeleni të papunë:

- për shkak të falimentimit të punëdhënësit ose
- sepse kompania ku ishit i punësuar është fshirë nga Regjistri i Bizneseve të Sllovenisë pa likuidim ose
- punëdhënësi juaj ka regjistruar biznesin e tij në një vend tjetër të BE/ZEE-së, por ju punoni pjesën më të madhe të punës në Slloveni mund të kërkonti të drejtën për tu paguar pagat e papaguara për tre muajt e fundit para fillimit të papunësisë, të drejtën për kompensim për punën e papaguar, pushimin vjetor të papërdorur dhe të drejtën për dëmshpërblim të ndërprerjes së punës. Këto të drejta mund ti kërkonti pranë Fondit Garantues.
- Lexoni më shumë rreth fondit garantues në faqen e internetit <http://www.jpi-sklad.si/skladi/jamstveni-sklad/>

### KU

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni Fondin e Bursave Publike, Zhvillimit, Invaliditetit dhe Mbijetesës të Republikës së Sllovenisë:

<http://www.jpi-sklad.si/skladi/jamstveni-sklad/>

Fondi i Bursave Publike, Zhvillimit, Invaliditetit dhe Mbijetesës të Republikës së Sllovenisë

Dunajska cesta 21

p. 3561

1116 Ljubljana

Tel.: +386 1 4720 990

<http://www.jpi-sklad.si/>

Email: [is.sr-spj@dalkspj](mailto:is.sr-spj@dalkspj)

Fondi Garantues

Numri i telefonit falas: 080 11 21

<http://www.jpi-sklad.si/skladi/jamstveni-sklad/>

Email: [jpsklad@jps-rs.si](mailto:jpsklad@jps-rs.si)



---

## ÇMIMI I SUBVENCIONUAR I KOPSHTIT

### ÇFARË

Nëse fëmijët tuaj janë të regjistruar në kopshtin e fëmijëve dhe puna juaj është ndërprerë, informoni kopshtin dhe komunën. Ju do paguani një çmim tjetër të subvencionuar për kopshtin.

Nëse fëmijët tuaj janë në shkollë fillore, ju mund të ushtroni të drejtën për ushqim të subvencionuar.

Për më shumë informacion, klikoni në vijim:

<http://www.csd-lj-siska.si/prejemki/subvencijaVrtca.asp>

### KU

Kërkesën dorëzoni pranë Qendres për Punë Sociale. Lista e Qendrave për Punë Sociale: <https://www.scsd.si/seznam-centrov-za-socialno-delo.html>

---

## TRANSPORTI I SUBVENCIONUAR PUBLIK NË LUBJANË

### ÇFARË

Si person i papunë, mund të blini një biletë mujore të transportit publik (Urbana) në Lubjanë me një çmim të zbritur. Kur të blini, do t'ju duhet të jepni dëshmi se jeni i papunë, dëshmin e lëshuar nga Enti i Punësimit të Sllovenisë,

### KU

Enti për Punësim:

<https://www.ess.gov.si/kontakt>

Transporti i udhëtarëve të Lubjanës: <http://www.lpp.si>

---

## KUOTA PËR PUNËSIMIN E INVALIDËVE

### ÇFARË

Për të ulur shkallën e papunësisë tek personat me aftësi të kufizuara në Slloveni, kompanitë duhet të veprojnë sipas kuotës për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Kjo kuotë përcakton pjesën e detyrueshme të personave me aftësi të



kufizuara në numrin e përgjithshëm të të punësuarve në kompani. Çdo punëdhënës i regjistruar në Regjistrin e Bizneseve të Sllovenisë me më shumë se 20 punonjës duhet të punësojë një numër minimal të personave me aftësi të kufizuara.

Rreth kuotës për punësimin e personave me aftësi të kufizuara mund të lexoni këtu:

<http://www.jpi-sklad.si/skladi/invalidski-sklad/>

## KU

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni Fondin e Bursave Publike, Zhvillimit, Invaliditetit dhe Mbijetesës të Republikës së Sllovenisë:

<http://www.jpi-sklad.si/>

Fondi i Bursave Publike, Zhvillimit, Invaliditetit dhe Mbijetesës të Republikës së Sllovenisë:

Dunajska cesta 21

p. 3561

1116 Ljubljana

Tel.: +386 1 4720 990

<http://www.jpi-sklad.si/>

Email: [is.sr-spj@dalkspj.si](mailto:is.sr-spj@dalkspj.si)

Fondi Invalidor

Tel.: +386 12309 480

Email: [is.vog@ofni-izvsrs.si](mailto:is.vog@ofni-izvsrs.si)

---

## ANËTARËSIM NË BIBLIOTEKË

### ÇFARË

Si person i papunë, ju merrni anëtarësim falas në të gjitha bibliotekat publike në Slloveni. Për të ushtruar këtë të drejtë, duhet të siguroni dëshmi të regjistrimit në regjistrin e të papunëve.

## KU

Në bibliotekën tuaj lokale. Lista e bibliotekave publike në Slloveni:

<http://zdruzenje-knjiznic.si/sistem-splosnih-knjiznic/mreza-splosnih-knjiznic/>





## Kompensim në para gjatë papunësisë

### ÇFARË

Nëse jeni të papunë, ju mund të ushtroni të drejtën tuaj për të përfituar kompensim gjatë kohës së papunësisë – të ardhura mujore të parave. Ju e keni këtë të drejtë gjatë papunësisë nëse keni qenë i punësuar dhe keni paguar sigurimin për raste të papunësisë që është pjesë e sistemit të sigurimit të detyrueshëm.

Shuma e kompensimit që do të merrni varet nga të ardhurat bruto mujore mesatare të marra gjatë tetë muajve para papunësisë.

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore (sigurimi shëndetësor, pensional dhe invalidor, sigurimi i papunësisë dhe mbrojtja e prindërve) përfituesve të kësaj të drejte gjatë periudhës së papunësisë u paguhen nga Enti i RS-së për Punësim.

Më shumë rreth kësaj të drejte mund të lexoni në faqen e internetit në vijim:

(në anglisht): [http://english.ess.gov.si/jobseekers/unemployment\\_benefits](http://english.ess.gov.si/jobseekers/unemployment_benefits)

(në sllovenisht):

[https://www.ess.gov.si/iskalci\\_zaposlitve/prijava\\_brezposelne\\_osebe/denarno\\_na\\_domestilo](https://www.ess.gov.si/iskalci_zaposlitve/prijava_brezposelne_osebe/denarno_na_domestilo)

### KUSH

- Personat të cilët kanë qenë të siguar për të paktën nëntë muaj në rast të papunësisë në 24 muajt para fillimit të papunësisë.
  - Personat nën moshën 30 vjeç, të cilët kanë qenë të siguar për të paktën gjashtë muaj gjatë 24 muajve të fundit.
  - Personat, punësimi i të cilëve nuk është ndërprerë me vendimin ose vullnetin e tyre. të cilët nuk u shkarkuan shkakun i mospërbushjes së përgjegjësive të tyre.
- Personat të cilët në mënyrë aktive kërkojnë punësim dhe përmbushin detyrimet e tjera që kanë si persona të papunë (ata vijnë në takime këshillimi





---

për punë, marrin pjesë në trajnime të dërguara nga këshilltari i tyre i punës, shkojnë në intervistat e punës etj.) (në sllovenisht) :

[https://www.ess.gov.si/\\_files/6051/pravice\\_in\\_obveznosti\\_brezposelna\\_ose\\_ba.pdf](https://www.ess.gov.si/_files/6051/pravice_in_obveznosti_brezposelna_ose_ba.pdf)

---

## **SI**

Për të ushtruar të drejtën për kompensim financiar, duhet të regjistroheni si person i papunë pranë Entit të Punësimit të Sllovenisë dhe të dorëzoni një kërkesë për ushtrimin e kësaj të drejte brenda 30 ditëve nga përfundimi i punës. Duhet t'i bashkëngjisni dokumentet e mëposhtme:

- kontratën tuaj të fundit të punësimit,
  - një certifikatë pagash (e plotësuar nga punëdhënësi juaj),
  - dëshmi për arsyen e ndërprerjes së punësimit.
- 

## **KUR**

brenda tridhjetë ditëve pas humbjes së punës.

---

## **MIRË ËSHTË TA DINI**

Qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe të Serbisë mund të marrin përfitime në rast papunësie vetëm nëse banojnë në Slloveni në bazë të lejes së qëndrimit të përhershëm ose të përkohshëm.

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë mund të marrin kompensim për përfitimet e papunësisë vetëm nëse kanë një leje qëndrimi të përhershëm.

---

## **KU**

<https://www.ess.gov.si/kontakt>



---

Themelimi i një kompanie si pronar i vetëm në Slloveni është e thjeshtë dhe zgjat më pak se tre ditë. Mënyra më e lehtë është të filloni një biznes online përmes pikës e-SPOT ku mund të rregulloni të gjitha formalitetet administrative në një vend. Procedura në e-SPOT është pa pagesë, por keni nevojë për një certifikatë dixhitale. Portali është në sllovenisht. Ju gjithashtu mund të themeloni një kompani edhe personalisht në pikën SPOT. Nëse nuk jeni shtetas i një shteti anëtar të BE-së, ju mund të themeloni një kompani në Slloveni si një afarist i vetëm i pavarur, nëse qëndroni për një vit në mënyrë legale (dhe të përherëshme) në Slloveni.

---

## HAPI

HAPI 1: para regjistrimit

Për të regjistruar një kompani si një sipërmarrës i vetëm i pavarur, do t'ju duhet:

- dokument i vlefshëm identiteti;
- numri tatimor slloven (certifikata e numrit tatimor slloven);
- numri i unifikuar i regjistrimit të qytetarëve (EMSO).

Zyrtarët në pikën SPOT do të rregullojnë:

- shënimin në Regjistrin e Bizneseve të Sllovenisë (Ajpes), në përputhje me datën e propozuar;
- roli i pronarit të pavarur në Administratën Financiare të Republikës së Sllovenisë;
- regjistrimin e sipërmarrësit të pavarur në skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësore të vetëpunësimit.

HAPI 2: procesi i regjistrimit



---

Në procesin e regjistrimit në e-SPOT ju propozoni datën e regjistrimit në Regjistrin e Bizneseve të Sllovenisë (Ajpes). Me postë ju do të merrni vendimin mbi regjistrimin – zakonisht brenda tre ditëve nga data e propozuar e regjistrimit. Me vendimin e regjistrimit të Ajpes, ju mund të hapni një llogari biznesi.

### HAPI 3: Procedura pas regjistrimit

Pas regjistrimit, ju duhet të njoftoni administratën financiare mbi sistemin e kontabilitetit që do të përdorni.

---

## KU

Lista e pikave të SPOT dhe noterëve (në sllovenisht):

<http://eSPOT.gov.si/info/spot-tocke-in-notarji/>

Më shumë informacion mbi themelimin e një kompanie si sipërmarrës i pavarur në e-SPOT është në dispozicion në faqen e internetit (në anglisht) <http://eugo.gov.si/en/starting/business-registration/sole-trader-sp/>



---

# Peshkatarit

---

## ÇFARË

Ky është një status i veçantë që mund të merret në qoftë se doni të angazhoheni në peshkimin tregtar në det. Me këtë status ju hyni në regjistrin e peshkatarëve – personave fizikë. Ata ju trajtojnë sikur të keni statusin e një mbajtësi të fermës, në lidhje me pensionin, aftësinë e kufizuar dhe sigurimin shëndetësor.

Më shumë informacion në lidhje me statusin e peshkatarëve mund të gjeni në faqen e internetit:

- E-  
Uprava <https://e-uprava.gov.si/podrocja/kmetijstvo-gozdarstvo-prehrana/divjad-lovstvo-ribolov/morski-gospodarski-ribic.html>
- E-  
SPOT <http://eSPOT.gov.si/info/dejavnosti/dejavnost/12419/prikaziDejavnost/>
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit:

[http://www.mkgp.gov.si/si/delovna\\_podrocja/ribistvo/morski\\_ribolov/pridobitev\\_statusa\\_ribica/](http://www.mkgp.gov.si/si/delovna_podrocja/ribistvo/morski_ribolov/pridobitev_statusa_ribica/)

---

## KUSH

Nëse mbijetoni veten me peshkim komercial dhe zoteroni një anije peshkimi. Ju gjithashtu duhet të plotësoni disa kushte të tjera. Lexoni më shumë rreth kushteve në faqen e internetit të e-Administratës (në sllovenisht):

<https://e-uprava.gov.si/podrocja/kmetijstvo-gozdarstvo-prehrana/divjad-lovstvo-ribolov/morski-gospodarski-ribic.html>

---

## SI

Nëse dëshironi të keni një status të tillë, kërkesën dorëzoni pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit.



---

Nëse keni një certifikatë dixhitale dhe një nënshkrim elektronik, ju mund të dorëzoni aplikacionin elektronik në e-Uprava <https://e-uprava.gov.si/podrocja/vloge/vloga.html?id=2458>

---

## KU

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit:  
Dunajska cesta 022  
1000 Ljubljana

Tel.: +386 1 478 90 00

<http://www.mkgp.gov.si/en/>

E [gp.mkgp@gov.si](mailto:gp.mkgp@gov.si)



---

# Licenca e Artizanatit

---

## ÇFARË

Nëse dëshironi të angazhoheni në një aktivitet të caktuar ekonomik dhe të drejtoni një kompani, ju nevojitet një licencë biznesi për artizanat. Disa aktivitete nuk janë të rregulluara, kështu që ju mund t'i kryeni ato pa kërkesa specifike. Për aktivitete të caktuara, megjithatë, ju duhet të plotësoni disa kushte dhe të merrni një leje të përshtatshme ose të jepni dëshmi të bashkëpunimit me një person që i plotëson kërkesat. Gjithmonë kontrolloni se aktiviteti ekonomik që dëshironi të bëni ose profesioni juaj kërkon autorizim dhe cilat kërkesa duhet të përmbushni. Për të marrë një licencë, ju duhet të siguronit dëshmi për kualifikimet përkatëse profesionale ose përvojën e punës. Lëshimi i licencës tregtare nuk është falas – ju duhet të paguani 111 EUR për shpenzimet e procedurës (në vitin 2017).

---

## HAPI

HAPI 1: Kontrolloni nëse plotësoni kushtet për një aktivitet të caktuar. Lista e licencave dhe lejeve është në dispozicion në faqen e internetit (në anglisht): <http://eugo.gov.si/en/permits/>

HAPI 2: Themeloni biznesin tuaj.

HAPI 3: Në portalin e-SPOT, pikën SPOT ose Oda e Sllovenisë për Artizanate dhe Biznes, kërkonit një licencë biznesi të duhur.

HAPI 4: Nëse licenca është miratuar, do të regjistroheni në regjistrin e artizanateve.



---

## KU

Aplikacionin dorëzoni në portalin SPOT (në sllovenisht:  
<http://eSPOT.gov.si/eSPOT/drzavljani/zacetna.eSPOT>), pika SPOT Regjistrimi ose  
Oda e Sllovenisë për Artizanate dhe Biznes. Lista e pikave SPOT  
(në sllovenisht): <http://eSPOT.gov.si/info/spot-tocke-in-notarji/>

ose kontakto

Oda e Sllovenisë për Artizanate dhe Biznes  
Celovška cesta 71, 1000 Ljubljana  
Telefoni: +386 1 583 05 01  
<http://www.ozs.si/>  
Email: [info@ozs.si](mailto:info@ozs.si)



# Marrja e një certifikate dixhitale SIGEN-CA për kompanitë

## ÇFARË

Me një certifikatë dixhitale, mund të dëshmoni identitetin tuaj dhe të nënshkruani në mënyrë digjitale operacionet elektronike. Në Slloveni, ekzistojnë disa certifikata digjitale për nënshkrime të sigurta elektronike, duke përfshirë SIGEN-CA, e cila lëshohet nga Ministria e Administratës Publike. Një subjekt biznesi duhet të ketë një kontratë të vlefshme me SIGEN-CA. Për më shumë informacion në lidhje me certifikatën dixhitale SIGEN-CA për subjektet e biznesit, vizitoni faqen e internetit (në sllovenisht): [http://www.sigen-ca.si/poslovnj\\_subjekti.php](http://www.sigen-ca.si/poslovnj_subjekti.php)

## KUSH

Bizneset.

## MIRË ËSHTË TA DINI

Në Slloveni ekzistojnë katër lëshues të certifikatave dixhitale. Ne Kompas in Podonavja kemi përshkruar vetëm një kompani. Përveç SIGEN-CA, Ministria e Administratës Publike mund të merrni certifikatat dixhitale nga lëshuesit sllovenë siç në vijim:

- Pošta Slovenije, d. o. o. – POŠTA®CA (në sllovenisht): <https://postarca.posta.si/navodila-za-ravnanje-s-potrdili/>
- Nova Ljubljanska banka, d. d. – AC NLB (në sllovenisht dhe anglisht): <http://www.nlb.si/ac-nlb-identiteta-ac-nlb>
- Halcom Informatika, d. o. o. – HALCOM (në anglisht): <http://www.halcom.si/en/products/digital-certificate/server-certificates/>





---

## HAPI

HAPI 1: Personi përgjegjës në kompani së bashku me ju (nëse jeni i punësuar) duhet të plotësojë kërkesën për marrjen e një certifikate dixhitale dhe ta dorëzojë atë në zyrën e Administratës Financiare. Në vend të personit përgjegjës të shoqërisë, kërkesa mund të paraqitet edhe nga një person tjetër i autorizuar në mënyrë specifike. Të dy aplikacionet janë në dispozicion në faqen e internetit (në sllovenisht): <http://www.siggen-ca.si/obrazci-org.php>

HAPI 2: Sapo të aprovohet aplikacioni, SIGEN-CA do të lëshoj një numër unik referimi dhe kodin e autorizimit. Ju do të merrni numrin e referimit përmes postës elektronike dhe kodin e autorizimit me postë.

HAPI 3: Vizitoni faqen e internetit SIGEN-CA, shkruani numrin tuaj të referencës dhe kodin e autorizimit dhe merrni një certifikatë dixhitale. Vlen pesë vjet. Certifikata dixhitale nuk mund të vazhdohet.

---

## KU

Personi përgjegjës i kompanisë paraqet kërkesën për certifikatë dixhitale SIGEN-CA në Administratën financiare (Ministria e Financave). Lista e zyrave financiare është në faqen e internetit (në sllovenisht): <http://www.fu.gov.si/kontakt/>



---

# Marrja e certifikatës dixhitale SIGEN-CA për qytetarët

---

## ÇFARË

Me një certifikatë dixhitale, mund të dëshmoni identitetin tuaj dhe të nënshkruani në mënyrë dixhitale operacionet elektronike. Në Slloveni, ekzistojnë disa certifikata digjitale për nënshkrime të sigurta elektronike, duke përfshirë SIGEN-CA. Është e lëshuar nga Ministria e Administratës Publike. Marrja e certifikatës dixhitale është falas për qytetarët sllovenë. Për më shumë informacion rreth certifikatës dixhitale SIGEN-CA për personat fizikë, vizitoni faqen e internetit: (në sllovenisht): [http://www.sigen-ca.si/fizicne\\_osebe.php](http://www.sigen-ca.si/fizicne_osebe.php)

---

## KUSH

Çdokush mbi 15 vjeç me Numrin e Identitetit të Unifikuar Slloven (EMŠO) dhe një numër tatimor.

---

## HAPI

Hapi 1: Në njësinë administrative më të afërt, së bashku me kartën e identitetit të vlefshme dhe me foto, personalisht paraqitni aplikacionin për certifikatën digjitale SIGEN-CA. Nëse jeni shtetas slloven jashtë vendit, aplikimi për një certifikatë dixhitale është i ndryshëm dhe ju mund të aplikoni për atë në përfaqësimin konsullor të Republikës së Sllovenisë. Të dy aplikacionet janë në dispozicion në faqen e internetit (një faqe interneti në gjuhën sllovene dhe angleze, ndërsa aplikacioni është në dispozicion në gjuhën sllovene, italiane dhe hungare): <http://www.sigen-ca.si/eng/eng-obrazci-fo.php>

Hapi 2: Sapo aplikacioni të miratohet, SIGEN-CA do të lëshoj një numër unik reference dhe kodin e autorizimit. Numrin e referimit do e merrni përmes postës elektronike dhe kodin e autorizimit me postë.



---

Hapi 3: Vizito faqen e internetit të SIGEN-CA, shkruani numrin tuaj të referencës dhe kodin e autorizimit dhe merrni një certifikatë dixhitale të vlefshme për pesë vjet. Nëse dëshironi të vazhdoni të përdorni certifikatën dixhitale SIGEN-CA, ju duhet të merrni një certifikatë të re. Brenda dy muajve para skadimit, ju mund të aplikoni për një certifikatë të re dixhitale së bashku me një certifikatë të vjetër dhe një formular interneti.

---

## **KU**

Aplikacionin për certifikatën digjitale SIGEN-CA e dorëzoni në njësinë administrative. Lista e njësive administrative gjendet në faqen e internetit: <http://www.sigen-ca.si/RA-fizicne.php>



---

# Themelimi i kompanisë sociale

---

## ÇFARË

Një person juridik jofitimprurës mund të fitojë statusin e një ndërmarrjeje shoqërore për veprimtarin e aktiviteteve të sipërmarrjes sociale dhe punësimin e grupeve të cënueshme të njerëzve. Qëllimi kryesor i krijimit të një ndërmarrjeje sociale duhet të jetë jofitimprurëse.

---

## SI

Për të themeluar një ndërmarrje sociale, së pari duhet të krijoni një entitet ligjor jofitimprurës si një shoqatë, një ent, një institucion, d. o. o. Ndërmarrja sociale nuk është person juridik, megjithatë, secila nga subjektet juridike të lartpërmendura mund të bëhet një ndërmarrje sociale. Ju mund të aplikoni për statusin e një ndërmarrjeje sociale në njësinë administrative ose në gjykatën ku është regjistruar organizata fillestare jofitimprurëse.

---

## KU

Lista e Njësisve Administrative: <http://www.upravneenote.gov.si/>

Më shumë informacion në lidhje me ndërmarrjet sociale keni në dispozicion në faqen e internetit

(në sllovenisht):

<http://eSPOT.gov.si/info/zacenjam/zelim-ustanoviti-podjetje/poslovne-oblike-podjetij/socialno-podjetje-sop/>

(në

sllovenisht): [http://www.mgrt.gov.si/si/delovna\\_podrocja/socialno\\_podjetnistvo/](http://www.mgrt.gov.si/si/delovna_podrocja/socialno_podjetnistvo/)



## Themelimi i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (d.o.o.)

### ÇFARË

Shoqërin me përgjegjësi të kufizuar (d.o.o.) është më së lehti ta themeloni online nëpërmjet pikës e-SPOT ku mund të rregulloni të gjitha formalitetet administrative në një vend. Procedura në pikën e-SPOT është e thjeshtë dhe e shpejtë, zgjat më pak se tre ditë dhe është falas. Ju nevojitet një certifikatë dixhitale. Portali e-SPOT është në sllovenisht. Ju gjithashtu mund të themeloni një kompani edhe personalisht në pikën SPOT. Kompanin mund ta regjistrojë çdokush. Procedura është e njëjtë për të gjithë qytetarët e BE-së, ZEE-së dhe Konfederatës Zvicërene. Nëse jeni shtetas i një vendi të tretë, do t'ju duhen dokumente shtesë.

### MIRË ËSHTË TA DINI

Disa aktivitete ekonomike kërkojnë leje ose licenca nga autoritetet. Lista e plotë e lejeve dhe licencave është në dispozicion në faqen e internetit (në anglisht):

<http://eugo.gov.si/en/permits/>

### HAPI

HAPI 1: para regjistrimit

Nëse jeni shtetas i një vendi të tretë, para fillimit të procesit, do të keni nevojë për dokumentet e mëposhtme:

- dokument identifikimi;
- numri slloven tatimor për individët;



- kapitali fillestar nëse biznesi juaj ka më shumë se një aksionar (p.sh. 50%, 1/3).

## HAPI 2: regjistrimi në pikën e-SPOT

Procesi i thjeshtë i themelimit të d. o. o. mund të bëhet me një partner (një themelues) ose me disa partnerë (disa themelues). Vetëm një partner mund të regjistrojë kompaninë në e-SPOT. Pika e-SPOT do t'ju udhëheqë përmes procesit dhe ju do të merrni të gjitha dokumentet përkatëse për hapat e ardhshëm. Më shumë informata në lidhje me themelimin e d. o. o. në pikën e-SPOT, keni në faqet e internetit në vijim:

(në

anglisht): <http://eugo.gov.si/en/starting/business-registration/limited-liability-company-doo/>

(në

sllovenisht): <http://eSPOT.gov.si/info/zacenjam/zelim-ustanoviti-podjetje/poslovne-oblike-podjetij/postopek-ustanovitve-enostavne-doo/>

## HAPI 3: Hapja e një llogarie të përkohshme bankare

Hapni një llogari bankare të përkohshme me një kapital fillestar prej 7,500 EUR. Konfirmimi i pagesës së kapitalit fillestar duhet të dorëzohet personalisht ose të dërgohet nëpërmjet e-SPOT.

## HAPI 4: Vendimi i regjistrimit

Brenda pak ditësh nga paraqitja e një kërkesë në gjykatë, do të merrni një vendim regjistrimi. Mesatarisht, aplikacionet përpunohen brenda katër ditëve. Së bashku me vendimin e regjistrimit ju do të merrni edhe numrin tatimor të shoqërisë

## HAPI 5: Hapja e një llogarie bankare

Pas marrjes së vendimit të regjistrimit, shkoni në bankë (ku keni investuar kapitalin fillestar) dhe ndryshoni llogarinë e përkohshme në një llogari të rregullt të biznesit.



---

## KU

Lista e pikave SPOT dhe noterëve (në sllovenisht): <http://eSPOT.gov.si/info/spot-tocke-in-notarji/>

Veç informacij o registraciji podjetja je na voljo na spletnih straneh (v slovenščini):  
Më shumë informacion mbi regjistrimin e kompanisë keni në dispozicion në faqen e internetit në vijim

(në sllovenisht): <http://eSPOT.gov.si/info/zacenjam/zelim-ustanoviti-podjetje/>

## Rikthimi gjyqësor i borxhit – ekzekutimi

---

### ÇFARË

Rikthimi i borxhit me anë të gjykatës është një situatë ku juridiksioni i shtetit përdoret për të mbuluar kërkesat dhe pretendimet. Mund të jetë për rikuperimin e të arkëtueshmeve të parasë së gatshme ose për të siguruar që aktivitete të caktuara të kryhen ose jo.

---

### SI

Për rikthimin gjyqësor të borxhit, ju duhet të paraqisni një kërkesë në gjykatën kompetente – një propozim. Ju mund të dorëzoni një kërkesë për përmbarrim në bazë të:

- dokument i verifikuar – dokument autentik (faturë, shënim noterial, ekstrakt nga librat e llogarisë etj.) ose
- titulli i zbatueshëm (një vendim gjyqësor i zbatueshëm, një dokument i drejtpërdrejtë i noterizuar).

Propozimi mund të dorëzohet me shkrim në formularin e caktuar (i cili nuk është i detyrueshëm), ose në mënyrë elektronike në e-portal. Të drejten ekskluzive për të ushtruar këtë detyrë, vetëm mbi bazën e një dokumenti të verifikuar – një dokument i besueshëm, e mban Gjykata Themelore në Lubjanë. Pas dorëzimit të



---

kërkesës, gjykata do të vendosë dhe do të zbatojë urdhrin e përmbarimit. Nuk ka asnjë formular të përshkruar për aplikimin në bazë të një titulli të zbatimit, prandaj përgatiteni vetë. Propozimit duhet bashkangjitur adresën e zbatimit. Dorëzoni kërkesën tuaj në gjykatën kompetente vendore. Juridiksioni vendor varet nga mjetet për zbatim. Sidoqoftë, procedura në asnjë mënyrë nuk është pa pagesë. Paguhet taksa gjyqësore.

---

## MIRË ËSHTË TA DINI

Nëse mendoni se do t'ju duhet të vazhdoni rikthimin gjyqësor të borxheve, është e dobishme të kontaktoni një avokat të specializuar, i cili mund t'ju këshillojë para se të filloni procedurat ligjore.

---

## KU

Gjykata Themelore në Lubjanë  
Miklošičeva 10, 1000 Ljubljana  
Telefoni: +386 1 474 76 00  
<http://www.sodisce.si/okraj/>

Email: [urad.ojlj@sodisce.si](mailto:urad.ojlj@sodisce.si)

Lista e të gjitha gjykatave themelore në Slloveni është në dispozicion në faqen e internetit (e disponueshme vetëm në gjuhën sllovene): [http://www.sodisce.si/sodisca/sodni\\_sistem/okrajna\\_sodisca/](http://www.sodisce.si/sodisca/sodni_sistem/okrajna_sodisca/)

Kërkesën mund ta dorëzoni edhe përmes e-portalit (e disponueshme vetëm në gjuhën sllovene): <https://evlozisce.sodisce.si/esodstvo/index.html>





---

# Prokurimi publik

---

## ÇFARË

Nëse keni një kompani që kryen shërbime qeveritare, ju mund të merrni pjesë në procedurat e prokurimit publik në të cilin qeveria kontraktton kompani private për të ofruar shërbime ose furnizime.

---

## KUSH

Kompania juaj mund të marrë pjesë në qoftë se plotëson kushtet e vendosura nga qeveria.

---

## SI

Çdo rast ka karakteristika të veçanta, në varësi të produkteve dhe shërbimeve të kërkuara dhe fushëveprimit të projektit:

- procedurat e hapura: çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë;
  - procedurat e kufizuara: pjesëmarrja mund të kërkohet nga çdo operator ekonomik dhe vetëm ato subjekte të ftuara nga autoriteti kontraktues mund të dorëzojnë një ofertë;
  - procedura me negociata: enti kontraktues fton operatorët ekonomik që të dorëzojnë ofertat e tyre dhe më pas të negociojnë kushtet kontraktuale me ta.
- 

## KU

Ministria e Administratës Publike, Drejtoria për Prokurim Publik (Ministry of Public Administration, Public Procurement Directorate)



---

Tržaška 19a, 1000 Ljubljana

Telefoni: +386 1 478 1880

[http://www.mju.gov.si/en/areas\\_of\\_work/public\\_procurement\\_directorate/](http://www.mju.gov.si/en/areas_of_work/public_procurement_directorate/)

Email: [gp.mju@gov.si](mailto:gp.mju@gov.si)

Drejtoria ofron konsultime telefonike për prokurimet publike për autoritetet kontraktuese dhe kontraktorët. Konsultimet mbahen të martën dhe të enjten ndërmjet orës 9 dhe 12.



---

# Ndryshimi i të dhënave të kompanisë

---

## ÇFARË

Kur ndryshon të dhënat e biznesit tuaj (për shembull, ndryshimi i adresës, anëtarët e bordit, përfaqësuesit e autorizuar), ju duhet të regjistroni këto ndryshime. Çdo ndryshim që është i rëndësishëm për Regjistrin e bizneseve të Ajpes duhet të komunikohet brenda 15 ditëve. Nëse jeni një pronar i vetëm (S. P.), ju mund të bëni ndryshime vetë (ose përfaqësuesi juaj) në portalin e-SPOT ose në njërën nga pikat SPOT. Nëse udhëheqni d. o. o., gjithashtu mund të raportoni ndryshime të vogla ose të thjeshta në pikat SPOT. Disa nga këto ndryshime janë: shtimi i aktiviteteve të biznesit, ndryshimi i biznesit, ndryshimi i adresës, gjë që gjithashtu shkakton ndryshime në aktin ose kontratën themeluese. Vetëm kontratat e thjeshta mund të regjistrohen në pikat SPOT. Ndryshimet më të mëdha dhe ndryshimet në formën e biznesit kërkojnë një vizitë tek noteri, i cili do të kryejë procesin e regjistrimit. Për më tepër, një përfaqësues i SPOT kontrollon nëse kompania juaj ka një strukturë kapitale më të kërkuar dhe, nëse është e nevojshme, ju drejton tek noteri. Nëse kontrata juaj ka formën e një akti noterial, ai mund të ndryshohet vetëm nga noteri.

---

## KU

Lista e pikave SPOT dhe noterëve (në slllovenisht):

<http://eSPOT.gov.si/info/spot-tocke-in-notarji/>



---

## Siguria dhe shëndeti në punë

---

### ÇFARË

Në Slloveni, punëdhënësi duhet të sigurojë një ambient pune të sigurt dhe të shëndetshëm në përputhje me Ligjin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë. Punëdhënësi duhet të përgatisë një vlerësim të rreziqeve për çdo punë ku identifikohen rreziqet dhe të përcaktojë dhe zbatojë masat për eliminimin e tyre. Para fillimit të punës, punëdhënësi duhet:

- Ta udhëzoj punonjësën në një ekzaminim mjekësor, para fillimit të punës. Kostoja e ekzaminimit mjekësor përballohet nga punëdhënësi.
- Të informoj punonjësën e ri mbi vlerësimin e rrezikut e vendit të punës së tij.
- Për punonjësën e ri të organizoj trajnime për sigurinë dhe shëndetin në punë. Trajnimi kryhet nga një inxhinier i sigurisë me një licencë të lëshuar nga Ministria e Punës, Familjes, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

---

### KUSH

Ligji për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë aplikohet për punëtorët.

---

### SI

Kur caktohet detyrat e punonjësve, punonjësit duhet të kenë parasysh:

- kualifikimet, konstituimin, moshën, gjinin dhe aftësit e kufizuara;
- dobësi fizike ose invaliditet (p.sh., dëmtimi i dëgjimit, dëmtimi i shikimit, grçe ose çrregullime të tilla si sulme etj);
- shmangia e kushteve që mund të jenë të rrezikshme për gratë shkak u natyrës së tyre;
- vëmendje e veçantë për punonjësit me aftësi të kufizuara.



---

Punëtorët duhet të informohen për rreziqet në lidhje me sigurinë dhe shëndetin e tyre dhe masat për t'i parandaluar ato. Përveç kësaj, ata duhet të marrin trajnim dhe të marrin materiale të sigurisë në përputhje me përvojën e tyre. Ata duhet të kenë një certifikatë trajnimi. Për disa fusha të punës është i nevojshëm trajnimi specifik.

---

## KU

Nëse të drejtat tuaja janë shkelur, ju lutemi kontaktoni

Inspektorati i Republikës së Sllovenisë për Punë (Labour Inspectorate of the RS),  
Verovškova ulica 64a, 1000 Ljubljana  
Telefoni: +386 1 280 36 60  
(në sllovenisht) <http://www.id.gov.si>

E-mail: [gp.irsd@gov.si](mailto:gp.irsd@gov.si)

Më shumë rreth sigurisë dhe shëndetit në punë mund të gjeni këtu (në sllovenisht):

[http://www.mdds.gov.si/si/delovna\\_podrocja/delovna\\_razmerja\\_in\\_pravice\\_iz\\_dela/varnost\\_in\\_zdravje\\_pri\\_delu/](http://www.mdds.gov.si/si/delovna_podrocja/delovna_razmerja_in_pravice_iz_dela/varnost_in_zdravje_pri_delu/)

dhe këtu (në sllovenisht): <http://www.osha.mdds.gov.si/>



## Mbrojtja sociale dhe sigurimi i punonjësve

### ÇFARË

Disa nga kontributet e sigurimeve shoqërore në Slloveni janë kontributet për sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor, punësimin dhe lejen e lindjes. Punëdhënësi juaj duhet t'ju regjistrojë në skemën e sigurimit të detyrueshëm të pensionit, sigurimin e sëmundjes dhe sigurimin e papunësisë në ditën e fillimit të punës tuaj.

- Sigurimi pensional dhe invalidor: Në Slloveni, është e obligueshme të jeni të përfshirë në sigurimin pensional dhe invalidor, i cili është i njëtrajtshëm për të gjithë personat e siguruar. Kushdo që paguan kontribute mujore për sigurimin pensional dhe invalidor nga paga e tyre konsiderohet të jetë personi me sigurim të detyrueshëm.
- Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor: Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, sigurohet nga Instituti i Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë. Të gjithë punonjësit dhe të vetëpunësuarit dhe pensionistët që marrin një pension nga një sigures slloven janë të siguruar sipas skemës së sigurimeve shëndetësore. Kjo ju ofron shërbime shëndetësore të paguara, kompensim pagash për mungesën nga puna për shkak të sëmundjes dhe rimbursimin e shpenzimeve të udhëtimit të lidhura me përdorimin e shërbimeve shëndetësore.
- Sigurimi shëndetësor vullnetar për mbulimin shtesë dhe sigurimin për shërbimet që nuk janë pjesë e sigurimit të detyrueshëm: Ju gjithashtu mund të bëni sigurim shëndetësor vullnetar të siguruar nga kompanitë e sigurimeve, me qëllim të marrjes së të drejtave shtesë. Rekomandohet që të kujdeseni për dallimin në vlerën e plotë të shërbimeve shëndetësore që nuk mbulohen nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm. Pjesa më e madhe e popullsisë përfshihet edhe në skemën e sigurimit shëndetësor vullnetar.
- Sigurimi për raste papunësie: Punonjësit që janë në marrëdhënie pune janë të detyruar të sigurohen për raste papunësie. Sipërmarrësit e pavarur, të vetëpunësuarit dhe në disa raste, njerëzit që kanë një biznes, qytetarët sllovenë të cilët janë të punësuar nga një punëdhënës jashtë vendit dhe bashkëshortët e tyre gjithashtu mund të sigurohen vullnetarisht për raste



papunësie.

- Kompensimi i pagave për mungesë nga puna për shkak të sëmundjes: Nëse ju sëmureni, punëdhënësi juaj paguan kompensimin e pagës për kohë të lirë pune për 30 ditët e para të mungesës suaj. Ju duhet t'i dorëzoni punëdhënësit një kartë sëmundje të lëshuar nga mjeku juaj i përgjithshëm. Pas 30 ditëve, kompensimi bëhet nga Shërbimi i sigurimeve shëndetësore, pas marrjes së mendimit të mjekut të përgjithshëm ose komisionit përkatës shëndetësor të Shërbimi i Sigurimeve Shëndetësore.
- Përfitimet familjare dhe të lindjes. Përfitimet familjare mund të kërkontë pranë qendrës për punë sociale për raste siç janë; kompensimi prindëror, ndihma gjatë lindjes së fëmijës, shtesat për fëmijë, shtesa për familje të madhe, ndihma për kujdesin ndaj fëmijëve dhe pagesë e pjesshme për të ardhurat e humbura. Përfitimet e tjera familjare përfshijnë kompensimi prindëror, ndihma gjatë lindjes së fëmijës, shtesa për familje të madhe, ndihma për kujdesin ndaj fëmijëve dhe pagesë e pjesshme për të ardhurat e humbura.

## SI

Punëdhënësi juaj duhet t'ju regjistrojë në skemën e sigurimit pensional, invaliditeti dhe atë shëndetësor, për raste papunësie, në njërin prej pikave SPOT ose në mënyrë elektronike në portalin e-SPOT. Nëse jeni një sipërmarrës i pavarur (S.P.), për sigurim duhet të regjistroheni kur filloni biznesin tuaj. Më shumë informacion mbi kontributet sociale keni në dispozicion në faqen e internetit (në anglisht):

[http://www.fu.gov.si/fileadmin/Internet/Davki\\_in\\_druga\\_dajatve/Podrocja/Mednarodno\\_obdavcenje/Vprasanja\\_in\\_odgovori/GB\\_Vprasanja\\_in\\_odgovori\\_1\\_izdaja\\_Social\\_security\\_contributions.pdf](http://www.fu.gov.si/fileadmin/Internet/Davki_in_druga_dajatve/Podrocja/Mednarodno_obdavcenje/Vprasanja_in_odgovori/GB_Vprasanja_in_odgovori_1_izdaja_Social_security_contributions.pdf)

## KU

Lista e pikave SPOT dhe noterëve (në slllovenisht: <http://eSPOT.gov.si/info/spot-tocke-in-notarji/>)



---

# Taksat

---

## MIRË ËSHTË TA DINI

Regjimi i taksave në Slloveni varet nga natyra dhe përbërja e aktiviteteve të biznesit të kryera nga kompania. Kontributet mujore të sigurimeve shoqërore dhe pagesa paradhënie të tatimit mbi të ardhurat paguhen nga punonjësit nga pagat e tyre. Tatimi mbi të ardhurat paguhet nga banorët e Sllovenisë. Të ardhurat e tatueshme janë të gjitha të ardhurat e banorëve sllovenë, burimi i të ardhurave të të cilëve është në Slloveni dhe jashtë vendit dhe të ardhurat e jorezidentëve, burimi i të ardhurave të të cilit është në Slloveni.

---

## TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH)

### ÇFARË

Kjo është një taksë e konsumit, e cila shton vlerën përfundimtare të produktit. Ka dy nivele të taksave – norma standarde është 22 për qind dhe më e ulët është 9.5 për qind në varësi të shërbimit ose mallrave. Ju do të bëheni i detyrueshëm për të paguar tatimet nëse qarkullimi juaj vjetor tejkalon 50,000, EUR.

### KU

Ministria e Financave, Administrata Financiare e Republikës së Sllovenisë, informata mbi TVSH mund të gjeni këtu në faqen e internetit: [http://www.fu.gov.si/davki\\_in\\_druge\\_dajatve/podrocja/davek\\_na\\_dodan\\_o\\_vrednost\\_ddv/](http://www.fu.gov.si/davki_in_druge_dajatve/podrocja/davek_na_dodan_o_vrednost_ddv/)

---

## TATIMI MBI TË ARDHURAT E PERSONAVE JURIDIK

### ÇFARË

Tatimpaguesit për tatim nga të ardhurat janë të gjithë personat juridikë, vendase dhe të huaja, me përjashtim Republikën e Sllovenisë dhe komunitetet lokale vetëqeverisëse. Personat juridikë të huaj janë të detyruar për tatimin mbi të





ardhurat, të cilat ata arrijnë në një biznes ose nëpërmjet një biznesi në Slloveni. Bazë për tatimin është fitimi i njohur si një tepricë e të ardhurave të tatueshme mbi shpenzimet e pranuarat tatimore.

Taksa paguhet në shkallën tatimore prej 19 përqind.

Baza e taksave mund të reduktohet duke aplikuar zbritjet tatimore.

## KU

Ministria e Financave, Administrata Financiare e Republikës së Sllovenisë, zyra financiare në të cilën ndodhet personi juridik. Kontaktet mund ti gjeni në faqen e internetit (në sllovenisht): <http://www.fu.gov.si/kontakti/>

---

## TATIMI MBI TË ARDHURAT (VLERËSIMI VJETOR)

### ÇFARË

Tatimi në të ardhura është një taksë mbi të ardhurat e personave fizikë. Të gjitha të ardhurat janë të tatueshme, përveç atyre që nuk konsiderohen të ardhura sipas Ligjit të Tatimit në të Ardhurat dhe ata që janë të liruar nga tatimi mbi të ardhurat personale sipas këtij ligji.

Tatimi mbi të ardhurat në nivel vjetor përcaktohet me vendim nga Administrata Financiare e Republikës së Sllovenisë (FURS).

## KU

Ministria e Financave, Administrata Financiare e Republikës së Sllovenisë, zyra financiare në të cilën jeni regjistruar në regjistrin e taksave. Kontaktet mund ti gjeni në faqen e internetit në vijim: (në sllovenisht): <http://www.fu.gov.si/kontakti/>

---

## KONTRIBUTET E SIGURIMEVE SOCIALE

### ÇFARË

Këto kontribute përfshijnë kontribute për pensionet, invaliditet dhe sigurimin shëndetësor, si dhe punësimin dhe lejen e lehonisë. 16.1 përqind paguhet nga punëdhënësi, ndërsa 22.1 përqind nga të punësuarit.



## KU

Ministria e Financave, Administrata Financiare e Republikës së Sllovenisë, zyra financiare në të cilën jeni regjistruar në regjistrin e taksave. Kontaktet mund ti gjeni në faqen e internetit në vijim: (në sllovenisht): <http://www.fu.gov.si/kontakti/>

## TATIMI NË PRONË

### ÇFARË

Tatimi paguhet nga personat fizikë që zotërojnë ose përdorin ndërtesat, pjesët e ndërtesave, apartamentet, garazhet dhe ambientet rekreative dhe relaksuese, pavarësisht nëse ato përdoren vetë ose jepen me qira.

Baza tatimore zbritet për 160 m<sup>2</sup> nëse pronari ose anëtari i tij i afërt i familjes, në vitin para vitit, për të cilën vendoset tatimi, ka banuar duke e përdorur si zonë banimi. Shkalla e tatimit për objektet e biznesit varion nga 0.15 në 1.25 për qind.

## KU

Ministria e Financave, Administrata Financiare e Republikës së Sllovenisë, zyra financiare në të cilën është e regjistruar palujtshmëria. Kontaktet mund ti gjeni në faqen e internetit në vijim: (në sllovenisht): <http://www.fu.gov.si/kontakti/>

## TAKSA E TREGTIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

### ÇFARË

Tatimi vendoset për shitjen e pronës nga çmimi i shitjes së pasurisë një shumë prej 2 përqind, kur nuk është llogaritur TVSH. Tatimpaguesi është shitësi i pasurisë së patundshme, megjithatë sipas kontratës tatimi mund të merret përsipër edhe nga blerësi. Për disa lloje të transferimit të pasurive të paluajtshme, është i mundshëm përjashtimi nga tatimi.

## KU

Ministria e Financave, Administrata Financiare e Republikës së Sllovenisë, zyra financiare në të cilën është e regjistruar patundshmëria. Kontaktet mund ti gjeni në faqen e internetit në vijim: (në sllovenisht): <http://www.fu.gov.si/kontakti/>



---

## AKCIZA

### ÇFARË

Akciza aplikohet për produktet e duhanit, alkoolit dhe pijet alkoolike, produktet energjitike dhe elektrike (vajra minerale, gaz natyror, qymyr dhe koks). Akciza paguhet për produktet e akcizës, bërë në Slloveni, importuar nga vendet e treta ose të blera nga një Shtet tjetër Anëtar i BE-së, nëse janë të destinuara për konsum në Slloveni.

Udhëtarët që udhëtojnë drejt Bashkimit dhe midis Shteteve Anëtare të Bashkimit janë subjekt i përjashtimeve të caktuara për pagesën e akcizës dhe doganës. Më shumë informacion për përjashtimet (në anglisht):

[http://www.fu.gov.si/en/customs/areas\\_of\\_work/travellers/](http://www.fu.gov.si/en/customs/areas_of_work/travellers/)

### KU

Ministria e Financave, Zyra e Administratës Financiare e Republikës së Sllovenisë, përgjegjëse për vendin tuaj të banimit, gjeni në faqen e internetit në vijim:

<http://www.fu.gov.si/kontakti/>

---

## DOGANA

### ÇFARË

Tarifat doganore llogariten për produktet e importuara në territorin doganor të Bashkimit nga vendet e treta që nuk janë pjesë e kësaj zone. Normat përcaktohen nga Tarifa e Përbashkët Doganore e Bashkimit Evropian dhe i nënshtrohen legjislacionit të përbashkët doganor të BE-së.

### KU

Ministria e Financave, Administrata Financiare e Republikës së Sllovenisë, Zyra përgjegjëse për vendin tuaj të banimit, i gjeni në faqen e internetit:

<http://www.fu.gov.si/kontakti/>



---

## **APLIKIMI PËR SIGURIMIN PENSIONAL DHE INVALIDOR, SIGURIMIN E PAPUNËSISË DHE SIGURIMIN SHËNDETËSOR**

### **ÇFARË**

Pasi të keni nënshkruar kontratën e punës, punëdhënësi juaj brenda 8 ditëve duhet të ju regjistroj në sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin e papunësisë dhe sigurimin shëndetësor pranë Institutit të Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë. përmes formularit M-1. Formulari M-1 duhet të dorëzohet nga punëdhënësi. Rekomandohet që të merrni një sigurim shëndetësor shtesë nga një prej kompanive të sigurimit komercial.

### **KU**

Instituti i Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë është i arritshëm këtu (në gjuhën sllovene):

<http://www.zzzs.si/index.html>

---

## **PAGA MINIMALE DHE TË ARDHURA TË TJERA NGA PUNËSIMI**

### **ÇFARË**

Nëse jeni punonjës me kohë të plotë tek një punëdhënës në Slloveni keni të drejtë për një pagë minimale. Paga minimale aktuale në Slloveni është 804,96 EUR. Nëse jeni i punësuar me kohë të pjesshme, ju keni të drejtë për një pjesë proporcionale të pagës minimale.

Ka edhe pagesa shtesë që nuk janë pjesë e pagës minimale dhe duhet të paguhet si të ardhura shtesë. Këto pagesa janë: pagesa për punën gjatë natës, pagesa për punën e së dielës dhe në kohën e pushimeve, regresi për ushqim gjatë punës, transporti për në punë dhe nga puna, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, pagesën vjetore për pushim, dëmshpërblimi për ndërprerje pune dhe shpërblimi jublues.

Nëse mendoni se janë shkelur të drejtat tuaja, kontaktoni Inspektoratin e Punës.

### **KU**

Nëse janë shkelur të drejtat tuaja të punës, kontaktoni Inspektoratin e Punës të



---

Republikës së Sllovenisë  
(Labour Inspectorate of the RS),  
Verovškova ulica 64a, 1000 Ljubljana  
Telefoni: +386 1 280 36 60  
<http://www.id.gov.si>  
Email: [gp.irsd@gov.si](mailto:gp.irsd@gov.si)



## Lista kontrolluese e dokumenteve të nevojshme për punësimin e një personi, duke përfshirë detyrimin e lajmërimit

### KUJDES

Ju kurrë nuk duhet të filloni punën tuaj para nënshkrimit të kontratës. Sipas ligjit, ju keni tre ditë për të shikuar dhe shqyrtuar përmbajtjen e kontratës para nënshkrimit.

### EKZAMINIMI SHËNDETËSOR

#### ÇFARË

Punëdhënësi duhet të ju udhëzoj në një kontroll shëndetësorë para punësimit. Kostoja e ekzaminimit mjekësor përballohet nga punëdhënësi.

#### KU

Lista e doktorëve të mjekësisë specialistike është në dispozicion në faqen e internetit (në gjuhën sllovene):

[http://www.mz.gov.si/fileadmin/mz.gov.si/pageuploads/aktualno/SEZNAM\\_marec2014.pdf](http://www.mz.gov.si/fileadmin/mz.gov.si/pageuploads/aktualno/SEZNAM_marec2014.pdf)

#### ÇFARË

Një leje pune në Slloveni lidhet drejtpërdrejt me një leje qëndrimi.

Ju duhet të aplikoni për një nga lejet e mëposhtme:

- Leje e njëtrajtëshme qëndrim dhe leje pune,
- Karta Blu e BE-së,
- leje pune për shtetasit e BiH.



Për të marrë një leje, para se të hyni në Slloveni, duhet të aplikoni në misionin diplomatik të Republikës së Sllovenisë jashtë vendit. Në të njëjtën kohë, punëdhënësi juaj duhet të aplikojë për një leje pune në Slloveni, para se të filloni punën dhe të paguani shpenzimet e procedurës. Në disa raste do t'ju duhet një leje shtesë për punë (punëtorë të udhëzuar, punëtorë sezonalë).

Ju keni qasje të lirë në tregun e punës në Slloveni nëse:

- keni leje qëndrimi të përhershme;
- keni një leje qëndrimi të përkohshëm – të huaj me origjinë sllovene, anëtarë të familjes së shtetasve slloven, viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore dhe punësim ilegal; dhe
- keni aplikuar për vazhdimin e lejes së qëndrimit tuaj.

qasja e lirë në tregun e punës është gjithashtu e mundur edhe për:

- përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare – refugjatët dhe personat që gëzojnë mbrojtje subsidiare;
- përfitues të mbrojtjes së përkohshme,
- aplikues i mbrojtjes ndërkombëtare (nëntë muaj pas dorëzimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare).

Qasja e lirë në tregun e punës do të thotë se mund të punoni nën të njëjtat kushte si qytetarët slloven dhe punëdhënësi juaj nuk ka nevojë për një leje pune të posaçme.

## KU

Përfaqësitë e Republikës së Sllovenisë në botë: (në sllovenisht):

[http://www.mzz.gov.si/si/predstavnistva\\_po\\_svetu/](http://www.mzz.gov.si/si/predstavnistva_po_svetu/)

Lista e Njësive Administrative gjendet këtu (në sllovenisht):

<http://www.upravneenote.gov.si/>

Për më shumë informacion rreth lejeve të qëndrimit, shih seksionin “Arritja dhe qëndrimi”.

---

## NËNSHKRIMI I KONTRATËS

## ÇFARË



Një punonjës i ardhshëm duhet të marrë një draft kontratë punësimi të paktën tri ditë përpara fillimit të punës së marrëveshur. Për punësim duhet të nënshkruhet një kontratë pune. Një kopje mbahet nga punëdhënësi dhe një nga punonjësi. Është gjithmonë më mirë të kemi një marrëveshje të shkruar në vend të marrëveshjes gojore. Kontratat e punës mund të nënshkruhen për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar dhe për kohë të plotë ose të pjesshme. Kontrata është e vlefshme kur nënshkruhet nga punonjësi dhe punëdhënësi. Kontrata duhet të përfshijë:

- emrat e palëve kontraktuese;
- emrin e pozitës dhe llojin e punës me një përshkrim të shkurtër të detyrave;
- datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e kontratës;
- lloji i punësimit / numri i orëve (me orar të plotë / me kohë të pjesshme);
- vendi i punës;
- Pagesa (bruto/neto) dhe tarifa të tjera, data dhe mënyra e pagesës së rrogës;
- e drejta për pushim;
- kushtet, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrimet e punonjësit që dalin nga punësimi;
- sanksionet në rast të sjelljes së paligjshme;
- kushtet e kontratës, duke përfshirë metodën e ndërprerjes dhe njoftimit;
- data e hyrjes në fuqi.

## KU

KU: Ministria e Punës, Familjes, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; Drejtoria për marrëdhënie pune dhe të drejta të punës; Departamenti për marrëdhëniet e Punës dhe Format e tjera të Punës (Ministry of Labour, Family, Social Affairs and Equal Opportunities, Labour Relations and Labour Rights, Employment Relationship Section)

(në

sllovenisht): [http://www.mddsz.gov.si/si/delovna\\_podrocja/delovna\\_razmerja\\_in\\_p ravice\\_iz\\_dela/](http://www.mddsz.gov.si/si/delovna_podrocja/delovna_razmerja_in_p ravice_iz_dela/)





---

## TRAJNIMI I SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

### ÇFARË

Punëdhënësi duhet të informojë punonjësin e ri për vlerësimin e rrezikut të kompanisë. Punëmarrësi duhet të marrë pjesë në trajnimin për shëndetin dhe sigurinë në punë. Trajnimi kryhet nga një inxhinier i sigurisë me një licencë të lëshuar nga Ministria e Punës, Familjes, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

### KU

Ministria e Punës, Familjes, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; Drejtoria për marrëdhënie pune dhe të drejta të punës; Sektori për Siguri dhe Shëndet në Punë (Ministry of Labour, Family, Social Affairs and Equal Opportunities, Labour Relations and Labour Rights, Health and Safety at Work Section) (në slllovenisht): [http://www.mddsz.gov.si/si/delovna\\_podrocja/delovna\\_razmerja\\_in\\_p\\_ravice\\_iz\\_dela/varnost\\_in\\_zdravje\\_pri\\_delu/](http://www.mddsz.gov.si/si/delovna_podrocja/delovna_razmerja_in_p_ravice_iz_dela/varnost_in_zdravje_pri_delu/)

## Shitja e kompanisë

---

### ÇFARË

Ju mund të shisni një kompani të themeluar (funksionuese) përsova të tjerë. Duhet të keni dëshmi se biznesi juaj nuk ka detyrime të fshehura. Ju mund ta shisni kompaninë në disa mënyra. Ju mund ta shisni vetë ose të punësoni një kompani për ta bërë atë për ju. Nëse e shisni vetë, mund ta komunikoni atë publikisht përmes mediave të ndryshme të biznesit dhe medias në industrinë tuaj. Mos harroni se shitja e kompanisë është një informacion i ndjeshëm andaj ndoshta është më mirë ta mbani diskrete. Keni parasysh se mund të huazoni një kompani të specializuar për t'ju ndihmuar me shitjen. Procesi i shitjes së një biznesi është i vështirë dhe ndonjëherë edhe afatgjatë. Kërkon të paktën hapat e mëposhtëm:

- përgatitjen e kompanisë për shitje;



- 
- vlerësimin e kompanisë;
  - reklamimin e shitjes së kompanisë;
  - kualifikimet e klientëve;
  - pasqyrën e gjendjes;
  - negociatat;
  - verifikim i hollësishëm;
  - nënshkrimin e një kontrate shitjeje.

